



NATIONAL
DEMOCRATIC
INSTITUTE
FOR INTERNATIONAL AFFAIRS

PARTITË POLITIKE, POLITIKAT PUBLIKE DHE DEMOKRACIA PJESËMARRËSE



EUROPA QENDRORE DHE LINDORE
PROGRAMI RAJONAL PËR PARTITË POLITIKE

Punojmë për demokracinë dhe mundësojmë atë të funksionojë

NDI është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse, jopartiake, që ka përkrahur institucionet dhe praktikat demokratike në secilin rajon të botës për më shumë se dy dekada. Që nga themelimi i saj në vitin 1983, NDI dhe partnerët e saj vendor kanë punuar për të krijuar dhe për të forcuar organizatat politike dhe qytetare, për të mbrojtur zgjedhjet, dhe për të promovuar pjesëmarrjen e qytetarëve, transparencën dhe përgjegjësinë në qeveri.

NDI e ka përpiluar këtë udhëzues me mbështetjen financiare të Ndhmës Amerikane për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED). Pikëpamjet e shprehura këtu janë të autorëve dhe nuk janë domosdoshmërisht në kundërshtim me pikëpamjet e NED.

Ky dokument u përgatit nga Shannon O'Connell në emër të Institutit Demokratik Kombëtar (NDI). Autorja dëshiron të falënderojë Ana Radiqeviq, Sef Ashiagbor, Natalie Hill dhe Ingrid Habets për udhëzimet dhe ndihmën e tyre të çmuar. Falënderime të veçanta për Angela Wilkins, Rob Tomas, Daisy Meyland Smith, Olle Burrell, Mark Thiessen, Terry Murphy dhe Jean Delalandre që ishin aq bujar me kohën dhe njohuritë e tyre të madhe, dhe për kontributin e tyre jetik për këtë projekt. Mirënjohje edhe për Ana Kadovic, Maja Nenadoviç dhe Antoine Ripoll për ndihmën e tyre.



National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world

E drejta e autorit © Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) 2011. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pjesë të këtij punimi mund të riprodhohen ose të përkthehen për qëllime jokomerciale nëse NDI njoftohet, si autor i materialit, dhe i dërgohen kopje të çdo përkthimi.



PARTITË POLITIKE, POLITIKAT PUBLIKE DHE DEMOKRACIA PJESËMARRËSE

Si Ndhmojnë Konsultimet e Brendshme dhe të
Jashtme Partive Politike Europiane në
Zhvillimin e Politikave Publike Përgjegjëse

Studim i Statuteve dhe Praktikave të Partive

Punojmë për demokracinë dhe mundësojmë atë të funksionojë



NATIONAL
DEMOCRATIC
INSTITUTE
FOR INTERNATIONAL AFFAIRS

455 Massachusetts Avenue, NW, 8th Floor
Washington, DC 20001-2621
p: 202.728.5500 f: 888.875.2887

www.ndi.org
www.twitter.com/ndi
www.facebook.com/national.democratic.institute

BORDI I DREJTORËVE

Kryesuesi

Madeleine K. Albright

Zëvendëskryesuesit

Harriet C. Babbitt

Thomas A. Daschle

Marc B. Nathanson

Sekretari

Patrick J. Griffin

Arkëtari

Eugene Eidenberg

Presidenti

Kenneth Wollack

Bernard W. Aronson

Elizabeth F. Bagley

Richard C. Blum

Donna Brazile

Joan Baggett Calambokidis

Robin C. Carnahan

Howard Dean

Sam Gejdenson

Shirley Robinson Hall

Rachelle Horowitz

Peter Kovler

Robert G. Liberatore

Kenneth F. Melley

Vali Nasr

Molly Raiser

Nancy H. Rubin

Elaine K. Shocas

Bren Simon

Michael R. Steed

Maurice Tempelsman

Lynda L. Thomas

Richard Verma

Randi Weingarten

James D. Wolfensohn

Këshilli

Frank M. (Rusty) Conner, III

Chairmen Emeriti

Paul G. Kirk, Jr.

Walter F. Mondale

Charles T. Manatt

(1936-2011)

KOMITETI

KËSHILLUES

William V. Alexander

Michael D. Barnes

John Brademas

Bill Bradley

Emanuel Cleaver, II

Mario M. Cuomo

Patricia M. Derian

Christopher J. Dodd

Michael S. Dukakis

Martin Frost

Richard N. Gardner

Richard A. Gephardt

John T. Joyce

Peter G. Kelly

Paul G. Kirk, Jr.

Elliott F. Kulick

John Lewis

Donald F. McHenry

Abner J. Mikva

Charles S. Robb

Esteban E. Torres

Andrew J. Young

Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse, jopartiake, që ka përkrahur institucionet dhe praktikat demokratike në secilin rajon të botës për më shumë se dy dekada. Që nga themelimi i saj në vitin 1983, NDI dhe partnerët e saj vendor kanë punuar për të krijuar dhe për të forcuar organizatat politike dhe qytetare, për të mbrojtur zgjedhjet, dhe për të promovuar pjesëmarrjen e qytetarëve, transparencën dhe përgjegjësinë në qeveri.

Përfshirë anëtarë e stafit dhe praktikantët vullnetarë politik nga më shumë se 100 kombe, NDI bashkon individë dhe grupe për të këmbyer idetë, njohuritë, përvojat dhe ekspertizën. Partnerëve u paraqiten qëndrime të gjëra nga praktikat më të mira në zhvillimin demokratik ndërkombëtar që mund tu përshtaten nevojave në vendet e tyre. Qasja shumëkombëshe e NDI-së përforcon mesazhin se përderisa nuk ekziston një model i vetëm demokratik, disa parime bazë të jenë të përbashkëta në të gjitha demokracitë. Objektivi kryesor i NDI-së është thellimi i demokracisë në mënyrë që të arrijë përmirësime të prekshme në jetët e njerëzve.

Pjesëmarrja e qytetarëve - Vënia e demokracisë në punë kërkon qytetarë të informuar dhe aktiv që ngrenë zërin për interesat e tyre, që veprojnë së bashku dhe që i mbajnë zyratë publikë të përgjegjshëm. NDI ndihmon qytetarët të angazhohen energjikisht në procesin politik dhe të shërbejnë si një lidhje ndërmjet qytetarëve dhe zyrtarëve të zgjedhur.

Zgjedhjet - NDI angazhohet me partitë politike dhe organizatat civile në edukimin e votuesit dhe qytetarit, reformën e ligjit zgjedhor dhe monitorimin e të gjitha fazave të procesit zgjedhor. Instituti ka punuar me më shumë se 300 grupe të qytetarëve dhe koalicioneve në 74 vende, ka punuar me qindra parti në promovimin e integritetit elektoral dhe ka organizuar mbi 100 delegacione ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve. NDI, gjithashtu, ka luajtur një rol udhëheqës në vendosjen e standardeve për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve.

Ndërtimi i Partive Politike - NDI punon me partnerët e saj në ndërtimin e partive politike - që nga procedurat e brendshme demokratike dhe përzgjedhjen e kandidatëve për votime, zhvillimin e platformës dhe shtrirjen publike. Instituti i ndihmon palët të promovojnë zhvillimin afatgjatë organizativ, rritjen e përfshirjes në zgjedhje, krijimin e kodeve të sjelljes, zbutjen e konfliktit politik, dhe pjesëmarrjen konstruktive në qeveri.

Qeverisja demokratike - NDI punon me legjislaturat nëpër botë për të ndihmuar në forcimin e komiteteve, të mbikëqyrjes legjislative, rregulloreve të punës, qasjes publike në informacion, grupeve parlamentare si dhe komunikimit të qëndrueshëm. Instituti gjithashtu ndihmon ministritë qeveritare, zyrat e kryeministrave dhe të kryetarëve të funksionojnë në mënyrë më efikase, të përmirësojnë kontaktet me qytetarët dhe të jenë më të përgjegjshëm ndaj publikut të gjerë.

Udhëheqja e grave - Që nga viti 1985, NDI ka organizuar programe në të gjithë globin për të rritur numrin dhe ndikimin e grave në jetën politike. Programet e Institutit kanë mbështetur gratë shumë gra të përfshihen në politikë, aq më të përgjegjshme do të bëhen institucionet ndaj nevojave të të gjithë qytetarëve. Në çdo kohë, gati 75 për qind e programeve të vendeve të NDI-së e kanë komponentin e dedikuar për adresimin e pjesëmarrjes politike të grave - në legjislatura, parti politike dhe në shoqëri civile për udhëheqës, aktivistë dhe qytetarë të informuar.

Punojmë për demokracinë dhe mundësojmë atë të funksionojë

NISMA RAJONALE E PARTIVE POLITIKE

Sfidat dhe mundësitë e demokracisë

Duke udhëhequr qeveritë dhe duke përcaktuar politikat publike, partitë politike në Ballkan ushtrojnë shumë pushtet, dhe pushtetin duhet ta përdorin për të dërguar vendet e tyre drejt Bashkimit Europian (BE). Kjo do të thotë që ato të bëhen organizata më gjithëpërfshirëse, të modernizojnë vendimmartjen, zhvillimin e politikave vizionare të bazuar në vlera të qarta dhe të lidhen përtej kufijve e të punojnë me partitë me të njëjtat pikëpamje. Partitë politike në rajon mund të mësojnë nga kolegët e tyre gjetiu në Europë në mënyrë që të prodhojnë politika që ndjekin vizionet e tyre.

Programi i NDI-së në Mbështetje të Demokracisë

Me financim të Ndhmës Amerikane për Demokraci (NED), NDI i ka ndihmuar partitë në Ballkan që të sqarojnë identitetin e tyre për krahas ideologjive bashkëkohore Sociale Demokratike, Liberale dhe të qendrës së djathtë, dhe të zhvillojnë politika koherente në përputhje me integrimin evropian. NDI punon me rreth 30 parti, dhe partnerë me fondacione partiake britanike, holandeze, gjermane, greke, sllovene si dhe suedeze që të mbajë seminare rajonale dhe që të nxis shkëmbime ndër-kufitare midis palëve me vlera të ngjashme.

Përmes kësaj nisme, partitë politike kanë forcuar strukturat e tyre të brendshme - si krijimi i organeve për zhvillimin e politikave në Partinë e Pavarur Liberale në Kosovë, formimin e forumit të grave dhe i platformës së saj politike në Partinë Social Demokratike të Serbisë, si dhe krijimi i një qendre trajnimit në Partinë Kombëtare Liberale të Rumanisë. Lidhje të reja janë duke u bërë në të gjithë rajonin në zhvillimin e politikave. Për shembull, dega e Partisë Demokratike Krahinore në Vojvodinë (Serbi), ndau qasjen e saj ndaj kredive për biznese të vogla me kërret e Lëvizjes Socialiste për Integrim në Shqipëri.

NDI ka mbështetur Rrjetin Liberal të Europës Juglindore (LIBSEEN), i cili ka themeluar një zyrë të përhershme si dhe bordin formal për vendim-marrje që të paraqesë një zë të përbashkët liberal nga rajoni në lidhje me BE-në. Lidhjet joformale të krijuara përmes programit rajonal po bëhen gjithnjë e më shumë rrjete formale të aktivistëve të partive të sfondit të ngjashëm në të gjithë rajonin. Partitë e qendrës së djathtë kanë themeluar një rrjet të zgjeruar rajonal të forumeve rinore. Gratë social demokratike krijuan një komitet drejtues për të lidhur aktivistet. Përmes këtij shkëmbimi rajonal, partitë i kushtojnë përpjekje në rritje hapjes së procesit të zhvillimit të politikave, duke mësuar nga përvojat e fqinjëve të tyre, në rajon dhe në Bashkimin Europian. Partitë dhe fondacionet e BE-së janë përgjigjur ndaj këtyre iniciativave duke investuar kohë dhe energji në rritje për partitë e tyre simotra në Ballkan.



Të rinjtë e partive konservatore nga i gjithë Ballkani diskutojnë lidhur me vlerat tradicionale për të ndërtuar konservativizëm modern – në takim rajonal të ftuar nga NDI.

TABELA E PËRMBAJTJES

Pjesa e parë: Hyrje dhe konteksti.....	7
Pjesa e dytë: Pasqyrë e Zhvillimit të Politikave me Pjesëmarrje.....	12
Pjesa e tretë: Raste për Studim të Partive Politike.....	16
Partia Laburiste, Mbretëria e Bashkuar.....	16
Partia Konservatore, Mbretëria e Bashkuar.....	22
Partia Social Demokratike, Suedi.....	26
Partia Popullore për Liri dhe Demokraci, Holandë.....	30
Fine Gael, Irlandë.....	32
Unioni për Lëvizjen Popullore, Francë.....	34
Pjesa e katërt: Rekomandime për Zhvillimin e Politikave.....	36
Pjesa e pestë: Lista e Burimeve.....	38



PJESA E PARË: HYRJA DHE KONTEKSTI

Sfidat për çdo sistem të politikbërjes janë të mëdha. . . Në botën moderne çështjet e politikave janë komplekse dhe zgjidhjet e propozuara janë gjithnjë e më teknokratike, debatet lëvizin me shpejtësi dhe vendimet kërkohen shpejtë. Në të njëjtën kohë ka një rritje të kuptueshme të dëshirës për konsultime, transparencë dhe reagime, në një botë ku jemi duke u bërë më pak konsumator pasiv e më tepër kontribuues aktiv.

**Rishikimi i politikbërjes në Partinë Laburiste të Mbretërisë së Bashkuar,
Konferenca e Partisë 2010**

HYRJE

Partitë politike në mbarë botën janë zhvendosur drejt modeleve të zhvillimit të politikave me më shumë pjesëmarrje. Modelet pjesëmarrëse të zhvillimit të politikave janë ato në të cilat një popullsi e gjerë si zyrtarë të partisë, anëtarë, mbështetës dhe grupe të jashtme, ndikojnë në politikat e propozuara dhe të mbështetura nga një parti e veçantë. Këto përfshijnë një gamë të gjerë temash, që nga buxheti kombëtar dhe zhvillimi ekonomik e deri te arsimi dhe kujdesi shëndetësor; që nga infrastruktura dhe transporti e deri te përkujdesja ndaj fëmijëve dhe pushimet e prindërve; nga zhvillimi i sektorit privat dhe programeve të punës deri te vlerat kryesore dhe besimet e partisë.

Në disa sisteme lëvizja drejt zhvillimit pjesëmarrës ose konsultativ të politikave është nismë e krerëve të partisë duke u përpjekur ti mbajnë anëtarët e partisë më të angazhuar dhe të dalin me politika më domethënëse për votuesit. Në raste tjera, lëvizja drejt zhvillimit pjesëmarrës të politikave vjen nga vetë anëtarësia, apo edhe nga organizatat e jashtme me një interes të veçantë në politikë e që kërkojnë që partitë politike të bëhen më të hapura dhe përfshirëse në zhvillimin e politikave të tyre.

Pa marrë parasysh nëse kalimi në zhvillimin pjesëmarrës të politikave vjen nga lidhshipi i partisë, anëtarët e saj apo nga presioni i jashtëm, rezultatet për vetë partinë janë pothuajse përgjithësisht pozitive. Proceset e zhvillimit pjesëmarrës dhe përfshirës të politikave japin përfitime direkte dhe afat-gjata për partitë politike dhe sistemet e qeverisjes. Këto përfshijnë politika më të qëndrueshme dhe të forta, me më shumë organizata politike konkurruese.

Ky dokument shqyrton strukturat dhe praktikën e politikbërjes të gjashtë partive politike në Europë, duke përfaqësuar një spektër të gjerë të qasjeve ideologjike dhe strukturore. Qëllimi i këtij dokumenti është që të ofrojë modele të veçanta pjesëmarrëse për partitë politike që kërkojnë të përqafojnë praktika më përfshirëse. Ky dokument u drejtohet veçanërisht, por jo vetëm, partive politike në vendet që kërkojnë anëtarësimin në institucionet Europiane.



Modelet e partive të paraqitura në këtë dokument janë nga partitë e mëposhtme:

	PARTIA	SHTETI	GRUPI PARLAMENTAR EUROPIAN
	Partia Laburiste	Mbretëria e Bashkuar	Aleanca Progresive e Socialistëve dhe Demokratëve
	Partia Konservatore	Mbretëria e Bashkuar	Konservatorët dhe Reformistët European
	Unioni për Lëvizjen Popullore	Francë	Partia Popullore Europiane
	Partia Popullore për Liri dhe Demokraci	Holandë	Aleanca Liberalëve dhe Demokratëve për Europë
	Fine Gael	Irlandë	Partia Popullore Europiane
	Partia Social Demokratike	Suedi	Aleanca Progresive e Socialistëve dhe Demokratëve

Në vazhdim është dhënë nga një rast studimi për secilën nga partitë, duke përfshirë një përmbledhje dhe hyrje të shkurtër, një rishikim të statutit të partisë, si dhe shqyrtimin e praktikave të zhvillimit të politikave të partisë.

Në këtë dokument termat politikëbërja pjesëmarrëse, konsultative, dhe përfshirëse janë përdorur të ndërthurura si mjet për të përshkruar proceset e politikëbërjes të cilat diskutohen, apo shprehin opinionet e anëtarëve, mbështetësve të partive politike, organizatave të shoqërisë civile dhe, në disa raste, të seksioneve më të gjëra të shoqërisë.

PSE DUHET KONSULTIM PËR POLITIKA?

Partitë politike adoptojnë modele përfshirëse të zhvillimit të politikave për një sërë arsyesh të ndryshme. Disa parti përmendin vlerat apo arsye në baza ideologjike për përfshirjen e anëtarëve dhe qytetarëve në politikëbërje. Të tjerët janë më praktik, duke theksuar faktin se konsultimi shpesh sjell mundësi të politikave më të forta, dhe më të rëndësishme. Për shembull, politikat për kujdesin shëndetësor që kanë përfshirë mendimet e ekspertëve mjekësorë dhe mjekëve në shërbime, së bashku me ato të shfrytëzuesve të kujdesit shëndetësor, kanë më shumë gjasa të jenë realiste, kuptimplote dhe të zbatueshme.

Konsultimi publik për politika po bëhet standard në Europë.

Tendenca drejt politikëbërjes pjesëmarrëse është veçanërisht i fortë në Europë pasi që anëtarët e partive kërkojnë ndikim më të madh në vendimet e marra nga partitë e tyre politike. Dhe, pasi që pjesëmarrja në votime dhe anëtarësimi në parti është në rënie anëmbanë kontinentit, partitë politike janë duke përdorur proceset pjesëmarrëse të politikëbërjes për të mbajtur veten të rëndësishme për votuesit.¹

¹ Për zgjedhjet Europiane të vitit 2009 [Fusnotat sugjerojnë shembuj. LMM] Partia e Europiane Socialiste u zhvilloi një konsultim të gjerë European rreth manifestit të saj në internet, me fokus të veçantë në përfshirjen e të rinjve. Shih, <http://www.euractiv.com/en/eu-elections/european-elections-outlook-2009/Neni-174694>



Konsultimi publik është duke u bërë një standard universal në qeverisjen europian. Organet qeverisëse europiane e kanë për detyrë që të bëjnë konsulta publike për politika, veçanërisht Komisioni Europian (KE), i cili harton dhe zbaton legjislacionin e Bashkimit Europian. Sipas rregullave të KE-së, duke përdorur konsultimin publik për të zhvilluar politika dhe legjislacionin sigurohet që “propozimet e politikave janë teknikisht të mundshme, praktikisht të realizueshme dhe të bazuara në qasjen nga poshtë-lart. Me fjalë të tjera, konsultimi i mirë i shërben një qëllimi të dyfishtë duke ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së rezultatit të politikave dhe në të njëjtën kohë në rritjen e përfshirjes së partive të interesuara dhe publikut në përgjithësi.”²

Për këtë arsye partitë politike të cilat kërkojnë një profil më të madh në Europë mund të gjejnë një tranzicion më të lehtë në politikën dhe procesin legjislativ të qeverisjes europiane në qoftë se ato tashmë janë duke praktikuar konsultime publike dhe/apo me anëtarësinë partiake në vendet e tyre.

Në mesin e partive brenda grupimeve politike europiane ekziston një tendencë të ndiqen fushata të përbashkëta për zgjedhjet europiane me, për shembull, kandidatët e Partisë së Gjelbër nga të gjitha vendet që konkurrojnë për zgjedhje në platformë të njëjta ose shumë të ngjashme. Partitë politike në vendet që aspirojnë t’i bashkohen BE-së do ta kenë më të lehtë të integrohen në këtë sistem në qoftë se kanë kulturë të brendshme dhe procese të ngjashme me homologët e tyre europianë, duke përfshirë edhe nëse ndërmarrin apo jo konsultime për politika.

Ka arsye shumë praktike për zhvillimin e politikave përfshirëse edhe jashtë standardeve dhe tendencave europiane. Praktikrat e tilla kanë tendencë të ndërtojnë parti dhe parlamentarë më të fortë me aftësi më të mira legjislative dhe të politikave, dhe që, prandaj, kanë më shumë gjasa për tu ri-zgjedhur. Arsye të tjera për angazhim në zhvillimin e politikave konsultative janë të dhëna në vijim.

Nga zhvillimi i një politike përfshirëse një parti mund të përfitojë në operacionalizim.

Konsultimet forcojnë aftësitë e ligjvënësve dhe zyrtarëve të partisë për t’u marrë me çështjet kryesore politike dhe ato legjislative. Konsultimet për politika mund të jenë bazë e mirë trajnuese për anëtarët e parlamentit të një partie, për mënyrën si të punojnë në procesin legjislativ.

- Proceset e brendshme demokratike dhe pjesëmarrëse i bëjnë partitë politike më të forta, më të afta kur kanë të bëjnë me negociim, debat dhe ndërtim të koalicionit. Proceset konsultative gjithashtu ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve më të forta mes partive dhe pjesëtarëve të tyre dhe/ose mbështetësve.
- Zhvillimi i politikave krijon mundësi për partitë politike që të përfshijnë gratë, komunitetet minoritare, të rinjtë dhe grupet sociale dhe ekonomike të nën-përfaqësuar në vendimmarrje.

Konsultimi mbi politika mund të ndihmojë një parti të ndërtojë profilin e saj si dhe të rrisë mbështetjen.

- Konsultimi mbi politika mund të jetë një proces emocionues dhe angazhues. Ai gjeneron debat brenda partisë, dhe për këtë arsye mund të jetë shumë motivues për anëtarët që të marrin pjesë.

² Komunikata e Komisioni Europian COM (2002) 704, “Parimet e përgjithshme dhe standardet minimale për konsultim të palëve të interesuara nga Komisioni, “http://ec.europa.eu/civil_society/consultation_standards/index_en.htm#_Toc46744739



- Përfshirja e anëtarëve të partisë në zhvillimin e politikave mund të ndihmojë që përpjekjet e fushatës të fillojnë herët, dhe ndihmojnë partinë të organizojë mbështetje dhe publicitet për agjendën e saj legjislative jashtë periudhës zyrtare të fushatës.
- Politikëbërja me pjesëmarrje mund të jetë një tregim i mirë në lajme dhe një mundësi për mbulim mediatik të çështjeve me rëndësi për partinë.
- Zhvillimi përfshirës i politikave fillon procesin e mbledhjes së mbështetjes publike për manifestin e partisë ose programit për qeveri, duke e bërë më të lehtë për të promovuar dhe zbatuar politikën.
- Teknologjia ka një ndikim rapid në atë se çfarë informacioni është në dispozicion në lidhje me partitë politike. Proceset gjithëpërfshirëse u japin partive politike mundësinë për të definuar veten dhe çështjet mbi të cilat ata duan të përqendrohen, në vend që ta lënë këtë të bëhet përmes mediave tradicionale dhe atyre të reja.
- Konsultimi jep përgjigje në pyetjet: “Çfarë të bëjmë për të mbajtur anëtarët e partisë të përfshirë dhe të angazhuar?” dhe “Si mund të tërheqim anëtarë të rinj?”

Struktura më të forta të zhvillimit të politikave do të thotë se partia ka më shumë gjasa për të ofruar politika më të mira.

- Zhvillimi përfshirës i politikave krijon mundësi për të siguruar një ekuilibër gjinor në tryezën e vendim-marrjes. Hulumentimet tregojnë se gratë janë më të prirura për të çuar përpara zhvillimin e politikave kryesore në fusha të tilla si shëndetësia, arsimi dhe infrastruktura³. Nivelet e larta të grave si vendim-marrëse janë të lidhura me qeveritë e të qenit në gjendje për të ofruar një standard të avancuar të jetesës për popullatën⁴ e tyre. Kjo krijon një përparësi zgjedhore për partitë që përfshijnë barazinë gjinore në politikëbërje.
- Politika që krijon një parti duke përdorur proceset konsultative ka më shumë gjasa të jetë e bazuar në realitetin dhe përvojat e votuesve, dhe për këtë arsye mund të ketë një shkallë më të lartë të mbështetjes publike.

Edhe pse teknologjia dhe kompleksiteti i çështjeve sociale dhe ekonomike kërkojnë përgjigje më të shpejtë dhe më teknike, nevoja që të sigurohet përfshirja e anëtarëve të partisë në vendime mbetet. Partitë me orientim demokratik janë duke kërkuar mënyra të reja për t'u ballafaquar me një mjedis më kërkues të politikave, ndërsa ende mbahen të forta, përfshirë edhe proceset e brendshme. Teknologjia, e cila ka përshpejtuar ritmin e ngritjes së çështjeve dhe shkurtime të kohës në dispozicion për përgjigje, gjithashtu është treguar të jetë një vlerë në përpjekjet për të përfshirë palët e interesuara në politikë.

³ Të dhënat për këtë pikë janë të shumta . Shih, Chen, Li-ju (2008) “ Politikëbërëset Femra dhe Shpenzimet Arsimore: Dëshmi Nër-Shtetërore” hulumtime në ekonomi të vitit 2008: 1 Univerziteti në Stokholm, Departamenti Ekonomik, rishikuar, 27 shkurt 2008. [http://ideas.repec.org/p/hhs/sunrpe/2008_0001.html], dhe Svaleryd, H. (2007) “Përfaqësimi i graas dhe shpenzimet publike.” [i shte rasti origjinal i ulët? LMM] IFN nr Fletë Pune 701, Instituti i Kërkimeve të Ekonomisë Industriale : Stokholm, Suedi, ose UNICEF (2006) “Gratë dhe fëmijët: dividenta e dyfishtë e barazisë gjinore.” [http://news.bbc.co.uk/1/shared/bsp/hi/pdfs/11_12_06SOWC2007.pdf].

⁴ Po aty.



SFIDAT PËR KONSULTIMET PËR POLITIKA

Zhvillimi i politikave me konsultime ofron një spektër të gjerë të përfitimeve për partitë politike, por kjo nuk do të thotë se kjo është e lehtë dhe pa komplikime. Zhvillimi i politikave mund të jetë një proces kompleks në çfarëdo rrethane, dhe përfshirja e më shumë palëve shpesh këtë e bën edhe më të vërtetë.

Praktikuesit e politikës në kërkim të zbatimit të proceseve konsultative për zhvillimin e politikave duhet të jenë të vetëdijshëm për sfidat e mëposhtme:

- Proceset përfshirëse në zhvillimin e politikave të marrin kohë, e cila duhet planifikuar. Disa çështje të politikave zhvillohen aq shpejt sa që nuk lejojnë të ndodhë një proces konsultimi i paramenduar, kështu që nuk mund të merret çdo vendim duke përdorur konsultim të gjerë.
- Përveç se politikëbërja duhet të jetë pjesëmarrëse, konsultative ajo mund të jetë luftarake pasi palët e ndryshme brenda partisë garojnë për dominim rreth politikave përfundimtare. Ky është një tension i natyrshëm i cili duhet të pritët dhe menaxhohet.
- Për më tepër proceset konsultative akademike apo të rënda mund të çojnë në ‘ konsultime të lodhshme ‘ në të cilën palët janë më pak të etura të marrin pjesë për shkak se puna është shumë e rëndë dhe e mërzitshme, ose nuk është e dobishme.
- Rezultati i proceseve konsultative nganjëherë mund të jetë i paqartë, kur palët nuk kanë pikëpamje të fortë për një politikë, pikëpamje gjerësisht të ndryshme, apo informata të pamjaftueshme.

Asnjë nga këto nuk është arsye për mos angazhim në format pjesëmarrëse të zhvillimit të politikave, por këto janë të meta të rëndësishme dhe sfida për tu mbajtur në mend ndërsa planifikohet e procesi.



PJESA 2: PASQYRË E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE ME PJESËMARRJE

ZHVILLIMI I POLITIKAVE NË STATUTET E PARTIVE

Ka një sërë zgjedhjesh për mënyrën se si një parti politike trajton zhvillimin e politikave në rregullat e saj zyrtare, të cilat zakonisht marrin formën e statuteve, të akteve nënligjore apo kushtetutës.

Shumica e rregullave të partive fillojnë duke përcaktuar vlerat në të cilat bazohet qasja e partisë për politikëbërjen, si e drejta e individëve për të bërë zgjedhje dhe për tu shprehur, apo zotimi për praktikën e brendshme demokratike, apo afirmimi i kongresit ose konventës si organi më i lartë vendimmarrës. Disa statute garantojnë qartë rolet e anëtarëve në zhvillimin e politikave partiake.

Nga këtu, statutet e partive kanë tendencë të marrin një qasje në të cilën një nga strukturat në vijim dominon zhvillimin e politikave, e që lirshëm mund të përshkruhet si përcaktim i detajeve në një shkallë të ulët, të mesme ose të lartë mbi procesin.

- 1. Statutet caktojnë se kush ka autoritet dhe deri në çfarë mase për t'u përfshirë në politikë, por nuk përshkruajnë ndonjë proces specifik (detajim i ulët).** Si Partia Popullore për Liri dhe Demokraci në Holandë edhe Fine Gael në Irlandë kanë statute që caktojnë përgjegjësitë për grupe të veçanta brenda partisë në zhvillimin e politikave, por shumë pak apo fare nuk shtjellojnë atë se si duhet të jetë procesi i zhvillimit të politikave.
- 2. Statutet krijojnë organe të veçanta me përgjegjësinë dhe autoritetin për politikëbërje dhe një rend të përgjithshëm të procesit (detajim i mesëm).** Si Partia Laburiste edhe ajo Konservatore në Mbretërinë e Bashkuar kanë krijuar forume të ndryshme nëpërmjet të cilave procesi i zhvillimit të politikave vihet në lëvizje dhe filtrohet. Aktorët tjerë janë të përfshirë, por organi për zhvillimin e politikave luan rolin kyç. Në statutet e partive është përshkruar deri në një shkallë rendi i përgjithshëm për zhvillimin e politikave dhe se si rrjedh ai përmes këtij organi.
- 3. Statutet përcaktojnë procesin e përgjithshëm me të cilin bëhen politikat dhe caktojnë role të veçanta për secilin aktor, duke përfshirë edhe udhëheqjen kombëtare të partisë, cilindo organizëm politikëbërës, degët lokale të partisë dhe anëtarët individualë (detajim i lartë).** Kushtetuta e Partisë Socialdemokratike Suedeze ofron një shembull më të detajuar të procesit të zhvillimit të politikave në të cilin roli i secilit aktor potencial është i përcaktuar që nga udhëheqja e partisë e deri te degët lokale.

Statutet e partive të shqyrtuara në këtë dokument ndjekin këto modele, por është e rëndësishme të theksohet, se në përgjithësi i lënë disi të turbullt hapat e saktë të vetë procesit të politikëbërjes. **Edhe statutet e partive të cilat shkojnë në më shumë hollësi rreth asaj se si funksionon hartimi i politikave janë të prirura ti lënë specifikat e hartimit ditë-pas-dite të politikave më të përgjithësuar.** Kjo u jep partive fleksibilitet që të përshtaten varësisht se si ndryshojnë çështjet dhe teknologjitë e reja me të cilat partitë komunikojnë. Kjo gjithashtu lejon krrerët e partive për të ushtruar vendimmarrje të përshpejtuar, kur çështjet janë urgjente, ose kur zgjedhjet janë të pashmangshme.



DOKUMENTET KONSULTATIVE

Shumica e konsultimeve për politika fillojnë me një draft-dokument mbi një apo disa çështje. Ky dokument vë shkurtimisht temën në kontekst, duke ofruar një sfond për këtë çështje dhe duke dhënë çfarëdo informate relevante se si e ka trajtuar partia atë në të kaluarën.

Dokumenti konsultativ pastaj do të përshkruajë debatin aktual rreth çështjes së dhënë dhe mundësitë për atë se si partia mund të vazhdojë dhe çfarë veprimesh mund të ndërmarrë. Kjo mund të përfshijë por nuk kufizohet në:

- mundësitë specifike të politikave për këtë çështje (p.sh. të mos bëjë asgjë, të formojë një agjenci të re, të riorganizojë një departament të qeverisë, të ndryshojë mënyrën se si është financuar çështja, etj), bazuar në kërkime apo në dëshmi;
- atë se sa përparësi duhet të ketë çështja për partinë, qeverinë apo opozitën;
- atë se kush brenda partisë, qeverisë apo opozitës duhet të përfshihet në marrjen e udhëheqjes në këtë çështje;
- në atë se cili(at) departament(e) të qeverisë duhet të jenë përgjegjëse për zbatim dhe /ose mbikëqyrje;
- sa të holla apo burime tjera duhet të investohen; dhe / ose,
- si duhet matur përparimi.

Së fundi, dokumenti do të përfshijë pyetjet e hapura për çështje të cilat do të donin përgjigje nga aktorët. Pa përfshirë pyetje specifike, konsultimet mund të marrin një reagim kaq të ndryshëm sa që mund të jetë e vështirë të identifikohen tema apo edhe gjetje të përbashkëta.

Dokumentet konsultative duhet të jenë sa më të shkurtra, thjeshta dhe të drejtpërdrejta për sa i lejon çështja në fjalë. Përdorimi i gjuhës së thjeshtë është me rëndësi jetike.

Dokumentet të cilat janë tepër akademike, ligjore, apo thjesht tepër të mëdha mund të jenë pengesë për aktorët që mund të kenë ide shumë të mira, por nuk kanë kohë për një kalim të lodhshëm nëpër vëllimet e dokumentit dhe nëpër gjuhën e koklavitur.

Ekspertët e politikave partiake thonë se, në qoftë se koha dhe burimet lejojnë, është e vlefshme që anëtarëve tu ofrohet një shumëllojshmëri e burimeve të ndryshme të informatave që tu jepet një pasqyrë e plotë rreth çështjes në fjalë. Kjo mund të përfshijë dokumente të ndryshme informuese apo informata mbi zhvillimet paraprake, ose takime të veçanta me ekspertë të cilët merren me temën e caktuar për të cilën partia zhvillon konsultimet.

Lidhjet me shembujt e dokumenteve konsultative mund të gjenden në Listën e Burimeve në pjesën e fundit të këtij punimi.



NJOFTIMI PËR KONSULTIME PËR POLITIKA

Dokumentet konsultative shpesh aktorëve u shpërndahen nëpërmjet postës elektronike, postës, apo në mbledhje. Ato gjithashtu mund të vendosen në faqen e internetit të partisë në mënyrë që individët të shkarkojnë apo tu përgjigjen online. Njoftimet për konsultime për politika vendosen në gazetatat partiake, revista, buletine, lista të postës elektronike, faqe të internetit, rubrika të gazetave, dhe në hapësira tjera relevante për njoftim. Shpesh, grupe të rastit për politika apo komisione të përhershme të politikave janë përgjegjëse për të siguruar shpërndarjen e duhur të konsultimeve.

Te partitë politike ku asambleja e përgjithshme apo kongresi e ka fjalën e fundit mbi politikën, draft-dokumentet e politikave u shpërndahen atyre me të drejtë vote dukshëm para mbledhjes. Në varësi nga struktura e partisë, mund të mbahen takime vetëm me anëtarësinë apo edhe takime publike për të diskutuar konsultimet.

PËRFSHIRJA E 'MEDIEVE TË REJA' NË KONSULTIME

Faqet e internetit të rrjeteve sociale, dhe dërgimi i mesazheve tekstuale janë duke u përdorur gjithnjë e më shumë si një mjet për të lehtësuar proceset konsultative për politika.

Për shembull, në përgatitje për zgjedhjet e përgjithshme në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2010, Liberal Demokratët themeluan dy faqet të ndara të internetit: njëra lejonte çdo individ të interesuar të përgjigjet në dokumentet konsultative në fushat e politikave të veçanta;⁵ tjetra ishte një faqe e kufizuar për anëtarët e partisë për të dhënë kontribut vetëm për manifestin e partisë për zgjedhjet e ardhshme.⁶

Partitë e tjera përdorin buletin elektronik për të informuar anëtarët për të reja në konsultimet për politika dhe për të dhënë një mekanizëm reagimi përmes postës elektronike. Dërgimi i tekst-mesazheve dhe njoftimet mes postës elektronike janë duke u përdorur për të njoftuar anëtarët e partisë dhe mbështetësit për konsultimin e ardhshëm për politika.

Një numër i partive mbajnë faqe specifike në rubrikat për diskutime për politika dhe çështje të brendshme partiake.⁷

KONSULTIMET E PLOTA PUBLIKE

Disa parti politike, veçanërisht ato në qeveri, e konsiderojë të dobishëm zgjerimin e politikëbërjes përtej anëtarësisë së tyre dhe, në disa çështje, përfshirjen e gjithë popullsisë së vendit në konsultim.

¹ "Medie të reja" rrjedh nga gjuha angleze "New Media" që nënkupton rrjetet sociale, internet, email, pra janë teknologjitë që mundësojnë ndërveprimin digjital.

⁵ <http://consult.libdems.org.uk/>

⁶ <http://manifesto.libdems.org.uk/>

⁷ Shih, për shembull, blog.conservatives.com i Partisë Konservatore në Mbretërinë e Bashkuar.



Për shembull, në vitin 2003, pas më shumë se gjashtë vitesh në qeveri, Partia Laburiste Britanike filloi një konsultim kombëtar të quajtur Bashkëbisedimi i Madh.⁸ Një dokument konsultimi 77-faqesh i fokusuar në 13 tema të gjera iu vu në dispozicion të gjithë qytetarëve të Mbretërisë së Bashkuar - pavarësisht nga përkatësia partiake apo politike – duke i ftuar ti paraqesin qeverisë mendimin e tyre për këto tema. Bashkëbisedimi i Madh filloi në disa vende nëpër Britani të Madhe dhe kishte faqen e vet të internetit nëpërmjet të cilës qytetarët kishin qasje në dokument dhe mund tu përgjigjeshin pyetjeve.

Partia Konservatore Kanadeze filloi një iniciativë të ngjashme në vitin 2010 dhe 2011 për buxhetin kombëtar. Të ballafaquar me fonde publike të zvogëluara, partia organizoi konsultime publike në zonat lokale për të mbledhur sugjerime nga votuesit se cilat programe apo shpenzime duhet të ndërpriten dhe çka duhet të ruhet për të ndihmuar vendin të dalë nga recesioni global.⁹

Konsultimet kombëtare për politika krijojnë mundësi të mira mediatike për partitë politike të përfshira. Por organizatorët e këtyre nismave të mëdha paralajmërojnë se ato duhet të menaxhohen me kujdes për të siguruar që gjithashtu të jenë edhe kuptimplote. Konsultimet e plota publike janë ngjarje aq të mëdha sa që mund të jetë e vështirë që në fund të fundit të lidhen sugjerimet e njerëzve me politikat që dalin nga konsultimi. Pa këtë lidhje, konsultimet e mëdha më shumë mund të duken si një marifet politik se sa si një zë i sinqertë ndjenjave publike.

⁸ Shih http://news.bbc.co.uk/1/hi/uk_politics/3245620.stm

⁹ Shih, <http://www.loisbrown.ca/riding-news/mp-brown-hosts-pre-budget-consultation-january-27> ose <http://earldreeshen.ca/riding-news/budget-2011-consultation-with-canadians>



PJESA 3: RASTE PËR STUDIM TË PARTIVE POLITIKE

PARTIA LABURISTE, MBRETËRIA E BASHKUAR



HISTORIKU DHE PËRMBLEDHJA

Partia Laburiste në Mbretërinë e Bashkuar u themelua në vitin 1900 nga një bashkimi i sindikatave, organizatave shoqërore demokratike, si dhe shoqërive socialiste. Në pjesën më madhe të historisë së saj politikave e partisë u krijuan pothuajse tërësisht nga konferencat, mbledhje të mëdha vjetore e anëtarëve të partisë, grupimeve të brendshme, dhe zyrtarëve me autoritet të votimit për vendimet e partisë.

Nga vitet 1980 ky proces ishte bërë kacafytës dhe kaotik. Propozimet për politika që rridhnin nga të gjitha nivelet e partisë dhe palëve të ndryshme luftonin për të dominuar procesin. Natyra antagomiste e procesit linte të kuptohej se shumë njerëz ishin lënë jashtë, dhe politikave e zhvilluara nuk mund ti transmetohen gjithmonë një audience të gjerë.

Në vitin 1997, nën udhëheqjen e Toni Blerit, Partia Laburiste miratoi një sistem të quajtur Partneriteti në Pushtet (PIP), i cili tentoi të reformojë këtë proces dhe krijoi disa institucione kryesore të politikëbërjes. Ky sistem dhe këto institucione filtruan dhe menaxhuan propozimet para konferencës dhe i dhanë partisë më shumë fleksibilitet për të marrë vendime për politika jashtë konferencës.

PIP kishte për qëllim të përmirësojë procesin e mëparshëm dhe të prodhojë politika të cilat mund ta bënin partinë më konkurruese në zgjedhje. Me fitoret e zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 2001 dhe 2005, mbështetësit e PIP-it thonë se arritja është e tij. Megjithatë, është bërë edhe një debat i rëndësishëm brenda partisë në lidhje me nëse është apo jo PIP-i mjaft gjithëpërfshirës. Si rezultat ka pasur disa ndryshime në proces, e të cilat kanë rritur ndikimin e palëve partiake, por procesi mbetet i diskutueshëm. Një konsultim dhe rishikim i gjerë partiak i PIP-it u realizua në vitin 2010, rezultatet pritet të shpallen në konferencën vjetore në vjeshtë të 2011-ës.

Institucionet e politikëbërjes janë të përcaktuara qartë në statutin e Partisë Laburiste, por procesi i politikëbërjes në vetvete nuk është. Kjo ka lejuar një masë të caktuar të fleksibilitetit dhe rishikimit se si është zbatuar PIP.

ZHVILLIMI I POLITIKAVE SIPAS STATUTEVE PARTIAKE

Partia Laburiste në Mbretërinë e Bashkuar udhëhiqet nga Rregullorja e Punës së Partisë. Dhjetë kapitujt e parë të Librit të Rregullores përshkruajnë rregullat kushtetuese të partisë e që ndikojnë në mënyrën e bërjes së politikave në parti. Aty përfshihen edhe programi rrjedhës i zhvillimit të politikave që çon në manifestin partiak të radhës të zgjedhjeve, si dhe cikli vjetor i punës mbi çështjet aktuale. Disa institucione janë themeluar për të zbatuar këtë proces, duke përfshirë Forumin Kombëtar për Politika (NPD), Komitetin e Përbashkët për Politika (JPC) dhe të gjashtë komisioneve për Politika. Nga këto, NPF është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të përgjithshëm të politikëbërjes.



Klauzola V e Librit të Rregullave thekson se si partia e përcakton programin e saj. Kjo klauzolë garanton që, “anëtarët, përfaqësuesit e zgjedhur, organizatat anëtare dhe kur është e praktike, komuniteti i gjerë kanë mundësi të marrin pjesë në procesin e shqyrtimit dhe formulimit të politikave”¹⁰.

Kjo pjesë e librit të rregullave gjithashtu thekson se konferenca e partisë përcakton “çfarë propozimesh specifike të reformës legjislative, financiare apo administrative, do të përfshihen në programin e partisë”, por në bazë të ndryshimeve, të krijuara nga PIP, zgjedhjet e konferencës tani janë, “të bazuara në programin e vazhdueshëm të paraqitur në konferencë nga Forumi Kombëtar për Politika dhe do të jenë subjekt i miratimit me votim ‘një anëtar, një votë’ e anëtarëve me të drejtë zgjedhjeje nga një herë në secilin Parlament”¹¹.

Për t’u përfshirë në programin e partisë, një propozim duhet të marrë mbështetjen e të paktën dy të tretave të votave të regjistruara në konferencë.

Më tej Klauzola V përcakton se kush në parti do të vendosë se cilat politika të partisë do të përfshihen në manifest, pra, plani që u paraqitet zgjedhësve në një vit zgjedhor si propozim i Partisë Laburiste për qeveri.

- Kur partia është në qeveri, ky organ përfshin anëtarë të ekzekutivit të partisë, si dhe përfaqësuesit e pesë organeve tjera drejtuese brenda partisë, duke përfshirë kabinetin qeveritar.
- Kur partia është në opozitë ky panel është shumë më i vogël, duke përfshirë vetëm anëtarët e ekzekutivit, përfaqësuesit legjislativ të grupit parlamentar të partisë, si dhe udhëheqësit dhe dy zëvendës udhëheqësit e Forumit Kombëtar të Politikave.

Klauzola V gjithashtu u jep këtyre organeve të rastit autoritetin për të, “përcaktuar qëndrimin e partisë për çështjet kryesore të ngritura nga zgjedhjet e të cilat nuk janë mbuluar nga manifesti”¹².

ZHVILLIMI I POLITIKAVE NË PRAKTIKË

Libri i Rregullave i Partisë Laburiste përcakton strukturat dhe autoritetet përgjegjëse për hartimin e politikave brenda partisë. Këto janë Forumi Kombëtar i Politikave, Komiteti i Përbashkët për Politika dhe Komisionet për Politika.

Ndërsa institucionet e politikëbërjes janë të përcaktuara qartë në statutin e partisë, procesi i politikëbërjes në vetvete është përshkruar në terma më të përgjithshme, duke garantuar një proces gjithëpërfshirës për anëtarët, por jo përfundimisht të përcaktuar se si do të jetë procesi. Kjo ka lejuar një sasi të caktuar të fleksibilitetit, dhe rishikimin e politikave brenda partisë, ndoshta duke e lejuar atë që të përshtatet me cilëndo situatë zgjedhore në të cilën mund të jetë.

Produkti përfundimtar i procesit të PIP-it është një doracak për politika, i cili përdoret si një dokument i partisë. Në prag të zgjedhjeve, zyra e udhëheqësit përpilon manifestin e partisë si një dokument të fushatës. Natyrisht, të dy dokumentet duhet të jenë në përputhje, por kjo nuk është gjithmonë kështu, që ajo që kërkon partia dhe ajo se çfarë janë nevojat e lidërshiptit të jenë të njëjta.

¹⁰ Libri i Rregullave i Partisë Laburiste 2010, Kapitulli 1, Klauzola V.1, fq. 10; <http://www.leftfutures.org/wp-content/uploads/2011/02/Labour-Party-Rule-Book-2010.pdf>

¹¹ Po aty., Kapitulli 1, Klauzola V.2, fq. 10.

¹² Po aty., Kapitulli 1, Klauzola V.3, fq. 10.



Forumi Kombëtar për Politika (NPF)

NPF është një nga institucionet kryesore në procesin e PIP-it dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e punës për zhvillim të politikave në parti. Kjo përfshin menaxhimin e konsultimeve me anëtarët e partisë dhe palët e interesuara për çështje të veçanta dhe duke përmbledhur rezultatet e konsultimeve. Sipas rregullave të partisë, NPF është formuar nga Komiteti Kombëtar Ekzekutiv i partisë (NEC), i cili është organi udhëheqës kombëtar i Laburistëve.¹³

NPF takohet rregullisht për të diskutuar dokumentet e prodhuara nga gjashtë komisionet e partisë për politika. Ajo pastaj dërgon dokumentet përfundimtare të politikave, si dhe raportet konsultative vjetore në konferencë.

NPF është i përbërë nga 194 anëtarë që përfaqësojnë të gjitha grupet kryesore të palëve me interes në parti. Rregullat e partisë përshkruajnë se sa përfaqësues do të ketë çdo pjesë e partisë në NPF. NEC-it i është dhënë autoriteti për të vendosur se si secili grup do të zgjedh anëtarët e tij, por rregullat e partisë përcaktojnë nivelet minimale të pjesëmarrjes së grave dhe të rinjëve.¹⁴

Një ndryshim i fundit në Librin e Rregullave parashikon që anëtarët individual të partisë të zgjedhin përfaqësuesit në NPF përmes një votimi postarë nga të gjithë anëtarët e partisë, teorikisht duke lejuar bazën e partisë të ndjejë se kjo ka një lidhje më të drejtpërdrejtë me vendimet politike. Ndarja aktuale e anëtarëve në NPF është si vijon:

Ndarja	Numri i anëtarëve në NPF
Organizatrat përbërëse të Partive Laburiste	55
Rajonet	22
Unionet tregtare	30
Anëtarët e Parlamentit	9
Anëtarët e Parlamentit European	6
Anëtarët e Dhomës së Lordëve (shokë)	2
Qeveria/Kabineti në hije	8
Shoqatat Socialiste	3
Studentët Laburist	1
Partia Kooperative	3
Forumet Velsiane, Skoceze dhe të Irlandës veriore për Politika	9
Labursitët e Zinj, Aziatikë dhe të Etnive Minoritare	4
Qeverisja Lokale	9
Komiteti Kombëtar Ekzekutiv	33
TOTALI	194

¹³ Po aty, Kapitulli 1, Klauzola VIII.3.I, fq. 12.

¹⁴ Po aty., Kapitulli 4, Klauzola C.1, Nënseksioni D, fq. 25.



Komiteti i Përbashkët për Politika (JPC)

JPC është projektuar për të siguruar mbikëqyrjen strategjike të zhvillimit të politikave. Ai kryesohet nga udhëheqësi i Partisë dhe përbëhet nga anëtarët e kabinetit (kur partia është në pushtet) apo kabinetit hije (kur partia është në opozitë), anëtarët e Komitetit Kombëtar Ekzekutiv të partisë (NEC), dhe NPF. JPC shërben si një grup drejtues për politika, duke drejtuar punën e NPF si dhe duke përcaktuar prioritetet dhe debatet.

Komisionet për Politika

Janë gjashtë Komisione për Politika në Partinë Laburiste që hartojnë raporte politike për diskutim nga JPC dhe NPF. Ato takohen disa herë në vit dhe janë përgjegjëse për shqyrtimin e parashtrimeve për politika nga të gjitha seksionet e partisë. Ato janë përgjegjëse për të siguruar që partia është e angazhuar në çështjet e rëndësishme dhe duhen të sigurojnë se ka dialog të vazhdueshëm në mes të partisë dhe kabinetit qeveritar/apo kabinetit në hije.

Çdo komision për politika ka 16 deri në 20 anëtarë që përfaqësojnë kabinetin qeveritar apo atë në hije, NEC-in, dhe NPF-në. Gjashtë komisionet janë:

- Britania në Botë
- Krijimi i Komuniteteve të Qëndrueshme
- Krimi, Drejtësia, Shtetësia dhe Barazia
- Edukimi dhe Aftësitë
- Shëndeti
- Përparimi dhe Puna

Të gjitha parashtrimet e politikave raportohen në Komisionet e duhura të Politikave dhe përdoren për të ndihmuar në hartimin e dokumenteve të politikave dhe për të informuar për prioritetet, programet e punës, dhe diskutimet e këtyre komisioneve. Çdo vit, komisionet prodhojnë një raport mbi punën e tyre në raportet e tyre Vjetore në Konferencë.

Konferenca

Çfarëdo që prodhohet nga NPF në fund i dorëzohet Konferencës për marrëveshje apo miratim. Prandaj, ajo për të cilën Konferenca është në gjendje të debatojë është përcaktuar kryesisht nga prioritetet e përcaktuara nga NPF, JPC, dhe komisionet për politika. Përrjashtim nga kjo është se çdo degë apo rajon i Partisë Laburiste (d.m.th., organizatë lokale partiake), ka të drejtë të paraqesë një rezolutë për një çështje të politikave në Konferencë e që nuk mbulohet nga puna e NPF.

Konferenca partiake duhet të mbledhet çdo vit, por mund të thirret edhe më shpesh nëse konsiderohet e nevojshme.



Cikli i Zhvillimit të Politikave

Procesi i PIP-it zhvillon manifestin e Partisë Laburiste në një cikël të përsëritshëm.

1. Faza e parë prodhon një dokument të vetëm të gjerë ose disa dokumente të vegjël që paraqesin çështjet ose temat kyçe të cilat partia pret ti ketë për trajtim pasi që ajo zhvillon politikat drejt zgjedhjeve të ardhshme.
2. Në fazën e dytë, dokumentet prodhohet për të përshkruar zgjedhjet e politikave mbi çështjet kyçe, pra, opsionet për mënyrën se si parti mund të merret me secilën çështje.
3. Në fazën e tretë, dokumentet përfundimtare të politikave, kur të prodhohen, konsiderohen për ndryshime në një takim të Forumit Kombëtar për Politika. Përmes përfaqësuesve të tyre NPF, secila njësi e partisë ka të drejtë të paraqesë amendamente në dokumentet e politikave në këtë fazë. Pas ndryshimit dhe marrëveshjes në NPF, dokumentet e politikave shkojnë më tej në Konferencën Vjetore për miratim.

Pas marrëveshjes, ata formojnë programin e partisë politike në të cilin bazohet manifesti për zgjedhjet e ardhshme.

Në letër, ky proces ndodh në një cikël tre-vjeçar. Megjithatë, për shkak të zgjedhjeve të parakohshme që u thirrën në vitin 2010, në praktikë, afati kohor është dashur të jetë më elastik që të përkojë me realitetet politike dhe zgjedhore.

Çështjet aktuale të cilat kërkojnë vëmendje jashtë procesit të paraparë tre fazësh filtrohen dhe diskutohen përmes Komisioneve të Politikave. Komisionet e politikave janë përgjegjëse për ti angazhuar aktorët e partisë në këto çështje.

Lidhja e Anëtarëve të Partisë në Politikëbërje

Që nga futja e PIP në vitin 1997, Partia Laburiste është ballafaquar me atë se si ti mbajë anëtarët e saj plotësisht të përfshirë dhe të njoftuar me vendimet politike, ndërsa në të njëjtën kohë të prodhojë propozime të politikave teknike, konkurruese dhe në afat për elektoratin. Mbrojtësit e procesit të PIP-it thonë se kjo ka prodhuar dy manifeste fituese të zgjedhjeve. Megjithatë, nuk ka pasur një opozitë të fortë dhe të vazhdueshme në këtë proces nga palët e interesuara brenda partisë që argumentojnë se kjo e ka centralizuar pushtetin dhe vendim-marrjen për çështjet e politikave të mëdha, dhe zbehin kontributin e anëtarëve të zakonshëm.

Udhëheqja e partisë vazhdon të përpiqet të arrijë një ekuilibër në mes të përfshirjes dhe efikasitetit. Në vitin 2008, anëtarë individualë të partisë ishin ftuar të paraqesin amendamente specifike teknike në fazën përfundimtare të dokumentit të politikave; NPF u pushtua nga vëllimi i amendamenteve të marra.

Teknikat dhe mjetet tjera të përdorura nga Partia Laburiste për të inkurajuar dhe për të ruajtur pjesëmarrjen e anëtarëve individualë dhe grupeve të interesuara në politikën e partisë përfshijnë:



- Një buletin me titull “Buletini - Dialogu - Partneritet në Pushtet”, i cili në intervale u është shpërndarë me postë elektronike çdo organizate lokale të partisë. Çështjet e kaluara janë në dispozicion të anëtarëve të partisë nëpërmjet faqes së internetit të partisë.
- Secili nga gjashtë Komisionet për Politika mban faqen e vet elektronike në të cilat ato postojnë të rejtat mbi punën e tyre. Anëtarët e partisë mund të jenë në kontakt me komisionet direkt përmes postës apo postës elektronike. Komisionet për Politika janë përgjegjëse në veçanti për angazhimin e anëtarëve të partisë dhe organizatave mbi çështjet aktuale.
- Në konferencën e vitit 2007, partia ndryshoi rregullat e saj për të lejuar që të gjitha organizatat anëtare dhe partitë lokale të paraqesin një çështje bashkëkohore në konferencë e cila nuk është trajtuar ndjeshëm nga raportet e NEC apo NPF në konferencë, duke lejuar bazën të ndikojë në agjendën e politikave e partisë.
- Partia është angazhuar gjithashtu në krijimin e dokumenteve të qarta, koncize, dhe në përfshirjen e dokumenteve politike, si dhe në mbajtjen e takimeve të grupeve të vogla për të diskutuar zhvillimin e politikave në mënyrë që më shumë njerëz të kenë mundësinë të marrin pjesë në diskutim.

Vlen të përmendet se PiP i mundëson partisë të konsultohet me organizata të jashtme mbi politikat, me të tilla si grupe të banorëve lokal, organizata të shoqërisë civile, organe profesionale, etj. Kjo e lejon partinë të përfitojë nga ekspertiza teknike të cilën mund të mos e ketë brenda, ndihmon partinë të lidhet më mirë me organizatat e votuesve, dhe ndoshta të promovojë një kulturë më ballafaqese brenda partisë.



PARTIA KONSERVATORE, MBRETËRIA E BASHKUAR



HISTORIKU DHE PËRMBLEDHJA

Partia Konservatore në Mbretërinë e Bashkuar është një parti e qendrës së djathtë me rrënjë që rrjedhin pas në të 1600-tat. Emri zyrtar i partisë është Partia Konservatore dhe Sindikale, por ajo më shpesh është e njohur si konservatorët apo me pseudonimin historik “Torët”.

Struktura e partisë është tepër e decentralizuar. Shoqatat lokale të partisë dominojnë zgjedhjen e udhëheqësve të partisë dhe përzgjedhjen e kandidatëve lokalë. Bordi i Partisë Konservatore është organ udhëheqës kombëtar dhe është përgjegjës për të gjitha çështjet operacionale.

Partia Konservatore ka një histori mjaft të gjatë të angazhimit të anëtarëve në zhvillimin e politikave. Qendra Politike Konservatore (CPC) është themeluar nga ana e partisë në vitet 1940 si një mënyrë për të lehtësuar komunikimin e dyanshëm për politika mes anëtarëve dhe udhëheqjes. CPC u zëvendësua në vitin 1998 nga ana e Forumit të Politikave Konservatore (CPF), i cili mbajti të njëjtin objektiv si CPC por futi një strukturë dhe procese të reja.

Shkalla në të cilën këto të dy organe ndikuan në rezultatin e politikave është një temë e debatuar brenda partisë. Shumë anëtarë debatojnë se ajo që shihej si efektive të CPC, CPF-ja nuk arriti të frymëzojë pjesëmarrje të nivelit të lartë dhe se, në fund, politikat u formuan kryesisht nga udhëheqja e partisë.

Pas zgjedhjeve të përgjithshme 2010, Udhëheqësi i Partisë Konservatore dhe Kryeministri David Cameron shpallën ringjalljen e CPF.¹⁵ Fokusi i CPF-së së ripërtërirë është të fillojë me ndërtimin e politikave drejt zgjedhjeve të përgjithshme në 2015 me të dhëna dhe rekomandime të anëtarëve të Partisë Konservatore.

CPF-ja gjithashtu siguron një mjet për Partinë Konservatore për ta dalluar veten në politika nga partneri i saj i koalicionit në qeveri, Demokratët Liberalë.

Roli, qëllimi dhe struktura e CPF në nivel kombëtar dhe lokal janë të përcaktuara qartë në Kushtetutën e Partisë Konservatore, por jo edhe vetë procesi politikëbërjes. Kjo lejon fleksibilitet në mënyrën e implementimit të procesit të zhvillimit të politikave dhe mënyrën në të cilën partia e organizon përfshirjen e reagimeve të anëtarëve.

ZHVILLIMI I POLITIKAVE NË STATUTET PARTIAKE

Kushtetuta e Partisë Konservatore kërkon që lideri i partisë të marrë në konsideratë pikëpamjet e anëtarëve dhe ato të Forumi të Partisë Konservatore kur të marrë vendime në lidhje me drejtimin politik të Partisë.¹⁶

¹⁵ Pas zgjedhjeve të përgjithshme, Partia Konservatore hyri në qeverinë e koalicionit me Demokratët Liberal.

¹⁶ Kushtetuta e Partisë Konservatore, e ndryshuar në korrik 2004, Pjesa III, Rreshti 11, fq. 6.



Kushtetuta gjithashtu ia përcakton CPF-së “ *funksionet kryesore të cilat do inkurajojnë dhe koordinojnë formulimin dhe zhvillimin e ideve të politikave dhe iniciativave brenda Partisë, veçanërisht Shoqatat Konstituive* ”.¹⁷ CPF duhet gjithashtu të përcaktojë një proces për marrjen e ideve dhe iniciativave për politika dhe, në mënyrë të konsiderueshme, të sigurojë që të jepen përgjigje për to.

Kushtetuta udhëzon CPF-në që të konsultohet për politika dhe të përfshijë të dhëna nga specialistët kur është e nevojshme, por nuk paracakton se si ky organ duhet ti kryejë këto detyra.¹⁸

Kushtetuta përshkruan strukturën operative të CPF-së, e cila menaxhohet nga një këshill i konstituuar në baza vjetore. Këshilli udhëhiqet nga një udhëheqës, i emëruar nga ana e liderit partiak, që normalisht do të jetë ministër i kabinetit apo kabinetit në hije. Shoqatat Konstituive lokale kanë tre përfaqësues të zgjedhur në këshill. Emërohen deri në pesë ekspertë individual të politikave, si dhe një përfaqësues i divizionit Skocez të partisë dhe një drejtor i lartë të partisë. Asnjë anëtar i zgjedhur nuk mund të jetë në këshill për më shumë se tre vjet.

Ekziston edhe një drejtor i CPF-së, i emëruar nga Bordi i Partisë Konservatore, organ udhëheqës kombëtar i partisë. Drejtori mbikëqyr aktivitetet operacionale të CPF-së, duke përfshirë koordinimin e punës politike të shoqatave lokale konstituive dhe grupimeve të CPF-së të formuara në nivel lokal. Këshilli i CPF-së duhet të takohet me udhëheqësit partiak të paktën dy herë në vit për ti diskutuar idetë politike dhe opinionet e anëtarësisë në lidhje me këto ide.¹⁹

Për çdo nivel të shoqatës partiake, nga njësia më e madhe e deri te më e vogla, të organizimit partiak, kushtetuta Konservatore parasheh që një person - zakonisht nënkryetari për politika, ta ketë përgjegjësinë për “ *formulimin dhe zhvillimin e ideve dhe iniciativave për politika* ”.²⁰ Kjo siguron që të ketë struktura deri në nivelin më të ulët lokal për gjenerimin e ideve politike të cilat mund ta ushqejnë udhëheqjen e partisë.

ZHVILLIMI I POLITIKAVE NË PRAKTIKË

Qendra Politike Konservatore është themeluar në vitet e pas Luftës së Dytë Botërore. Puna e CPC-së u organizua rreth një programi për diskutim në të cilin grupet e anëtarëve të partisë do të takohen për të diskutuar një përmbledhje temash të lëshuara nga zyra qendrore e partisë. Secili grup emëron një udhëheqës i cili do të shkruaj një raport që paraqet rezultatet dhe idetë e grupit për temat. Zyra qendrore e partisë rishikon raportet e marra me shkrim dhe paraqet një përmbledhje të përmbajtjes të Ministri përkatës apo Ministri në hije.

Ka pasur seminare dhe konferenca të rregullta të CPC-së, të njohura si Shkolla Verore dhe Dimërore, gjatë të cilave zyrtarët e shquar Konservatorë dhe ekspertë të politikave paraqitën vizionet e tyre mbi çështjet përkatëse.

CPC, në vitin 1998, u zëvendësua nga Forumi Konservatorë i Politikave si pjesë e një pakete të reformave për të ringjallur partinë pas humbjes zgjedhore në vitin 1997.

¹⁷ Po aty, fq. 13.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty., Fq. 14.

²⁰ Po aty, fq. 30, 44, 47.



CPF ishte një projekt më ambicioz, i cili u përpoq të sjellë më shumë anëtarë përmes ngjarjeve të mëdha politike dhe një strukture më të gjerë. Megjithatë, ka pasur pak konsistencë në mënyrën se si CPF-ja e menaxhoi dhe nuk e ka arritur nivelin e pjesëmarrjes apo suksesit që ishte parashikuar. Reformimi i CPF-së në vitin 2011 ishte një përpjekje për t'iu përgjigjur kërkesës së vazhdueshme brenda partisë për zhvillimin e politikave me pjesëmarrje, e kombinuar me pranimin se strukturat e mëparshme nuk e përmbushën këtë nevojë.

Pas zgjedhjeve të përgjithshme të 2010-tës, Partia Konservatore hyri në qeverinë e koalicionit me Demokratët Liberal, një parti me politika Liberale. CPF-ja e rivitalizuar, gjithashtu, plotësoi nevoja të rëndësishme në këtë drejtim: krijimi i një konceptimi politik të qartë dhe të dallueshëm të Partisë Konservatore për zgjedhjet e përgjithshme të 2015-tës, dhe për të mbrojtur identitetin e partisë derisa është në qeveri me një parti ideologjike aq të ndryshme. Prandaj, CPF-ja nuk punon në çështjet e politikës aktuale, por përqendrohet vetëm në ndërtimin e politikave për 2015-ën.

Në një rast të ri-nismës zyrtare të CPF-së, bashkëudhëheqësja e partisë Baronesha Warsi deklaroi se CPF *“bën të qartë për çdo anëtar Konservatorë se nuk ka rëndësi se kush jeni, ku jetoni, apo çfarë përvoja politike keni, në Partinë tonë ju do të keni një zë të fuqishëm në lidhje me çështjet që kanë rëndësi për Britaninë - dhe zëri juaj do të dëgjohet dhe do të konsiderohet. . . Në saje të strukturës së re të CPF-së, ekziston një vijë e drejtë që shkon nga zona juaj e deri te Ministrat Konservatorë në qeveri”*.²¹

CPF-ja e riformuar përcaktoi një listë të temave të përgjithshme në të cilat do të kërkojë reagime në baza të vazhdueshme, si dhe një orar të rregullt të dokumenteve tematike të cilat do ti nxjerrë për konsultim në baza mujore. Disa nga çështjet mbi të cilat partia kërkon këshilla përfshijnë:

- një popullsi në plakje
- sfidat e reja të sigurisë
- ndryshimet në teknologji dhe inovacione
- presioni në rritje ndaj burimeve natyrore
- sfidat nga ekonomitë në zhvillim
- shkaqet e varfërisë
- sigurimi i një shkalle më të lartë të punësimit
- dhënia e strehimit më të përballueshëm
- shkatërrimi i pabarazisë në të ardhura dhe varfëria e fëmijëve
- mbrojtja e kapitalit natyrorë
- zvogëlimi i shkallës së burokracisë qendrore

Anëtarëve të Partisë iu kërkua të formojnë grupet e veta lokale të politikave në mënyrë që të përgjigjet në këto tema dhe të gjenerojnë idetë e tyre mbi politika jashtë këtyre temave të caktuara. Grupeve lokale CPF u është caktuar mandati dhe procesi në vijim:

²¹ <http://conservativehome.blogs.com/thetorydiary/2011/01/baroness-warsi-explains-what-she-hasdone-for-party-members-since-becoming-chairman-as-she-re-launch.html>



- Grupet e CPF-së do të kontribuojnë në forcimin e fushatës së shoqatës lokale të Partisë Konservatore;
- Grupet e CPF-së do të takohen gjatë tërë vitit;
- Grupet e CPF-së do të raportojnë qendrës;
- Grupet e CPF-së do të inkurajohen të shtrihen deri te komunitetet e tyre që të diskutojnë idetë e tyre; dhe
- Një përmbledhje e pikëpamjeve mbi dokumentet e caktuara për sfidat e së ardhmes do të dërgohet te Ministri përkatës Konservatorë i cili pastaj do të përgjigjet.

Grupet lokale dhe individët inkurajohen të përgjigjen në konsultime me postë elektronike.²² CPF gjithashtu mban faqen e vet të internetit, ndaras nga faqja e internetit të partisë, nga e cila anëtarët mund të shkarkojnë të gjitha dokumentet aktuale të politikave dhe të gjejnë një CPF lokale në atë rajon.²³ Stafi i CPF-së përdor rregullisht rubrikat e Partisë Konservatore për të njoftuar dhe për të promovuar konsultimet për idetë specifike për politika.

Në një proces të ngjashëm me atë të përdorur nga CPC, parashtrimet në çdo dokument lexohen nga ekipi kombëtar i CPF-së dhe sistemohen në një përmbledhje. Kjo përmbledhje dërgohet te ministri përkatës i cili pastaj përgjigjet. Përgjigjja e ministrit pastaj u shpërndahet anëtarëve.

Këto diskutime të shkurtra mujore formojnë kurrizin e punës së CPF-së, por ka edhe mundësi tjera për reagime dhe konsultime. CPF organizon ngjarje në konferencat e partisë, si edhe vet Konferencën e Dimrit të CPF. Aktivitetet tjera përfshijnë tribunat, ligjërata vjetore dhe diskutime jofor-male për anëtarët e partisë me Ministrat e partisë dhe anëtarët e Parlamentit për çështje relevante për portofolet e tyre.

²² cpf@conservatives.com

²³ <http://www.conservativepolicyforum.com>



PARTIA SOCIAL DEMOKRATE, SUEDI



HISTORIKU DHE PËRMBLEDHJA

Partia Social Demokrate Suedeze (SAP) u themelua më 1889 dhe është partia më e vjetër dhe më e madhe politike në Suedi. SAP përdor një model me pjesëmarrje të lartë në politikëbërje i cili lejon pothuajse të gjitha nivelet e organizatave partiake - nga degët ekzekutive dhe lokale deri te anëtarët individual - të marrin pjesë në proces.

Partia udhëhiqet nga një kushtetutë e cila e përcakton kongresin si organin më të lartë të vendim-marrjes brenda partisë. Në vitet në të cilat nuk mbahet kongresi, kushtetuta përcakton një Bord Kombëtar për të marrë vendime strategjike. Kushtetuta gjithashtu parasheh një Komision për Programin, i cili merret kryesisht me lëvizjet që ndikojnë në vlerat kryesore të partisë. Bordi Kombëtar menaxhon vendimet për angazhimet e politikave të partisë dhe propozimet. Propozimet e politikave të bëra nga dy organet duhet të miratohen nga kongresi.

Në praktikë, SAP zhvillon politika për tri qëllime të ndryshme: Programin e Partisë, Udhëzimeve Politike dhe Manifestit të Partisë.

Në vitin para se kongresi të mbahet, Bordi Kombëtar qarkullon dokumente konsultative për politikën e partisë, të cilat diskutohen në takime lokale dhe nga grupet për diskutime tematike në internet. Degët e partisë, klubet, dhe anëtarët individual paraqesin reagimet e tyre në Bordin Kombëtar, i cili përdor këto informata për të udhëzuar dhe drejtuar propozimet e politikave të cilat ia paraqet në kongresi.

ZHVILLIMI I POLITIKAVE NË STATUTET PARTIAKE

Partia Social Demokratike Suedeze është e qeverisur nga një kushtetutë. Kushtetuta përcakton kongresin si organin suprem të vendimmarrjes në parti.²⁴

Kushtetuta përcakton që Kongresi të mbahet në vitin para zgjedhjeve të përgjithshme. Zgjedhjet në Suedi janë përcaktuara dhe mbahen çdo katër vjet, që do të thotë se Kongresi i SAP gjithashtu mbahet një herë në katër vjet. Kongrese të jashtëzakonshme mund të thirren jashtë këtij cikli për të diskutuar çështje të mëdha, të tilla si zgjedhja e një udhëheqësi të ri të partisë.

Kongresi përbëhet nga 350 delegatë të zgjedhur. Disa nga këto vende janë mënjeluar për organizatat e partive të ndryshme, por shumica janë të shpërndara ndër rrethet partiake në bazë të shkallës së anëtarësisë.

Partia mund të thërrasë një konferencë të vogël, të quajtur Këshilli i Partisë, në të gjitha vitet e tjera në të cilat kongresi nuk mbledhet. Këshilli i Partisë është i përbërë nga 120 delegatë dhe mund të thirret në bazë të rastit për t'u marrë me çështjet që lindin, por duhet të mbledhet të paktën një herë në vit dhe thirret gjithmonë për të zgjedhur komitetin e nominimit të kongresit.

²⁴ Kushtetuta e Partisë Social Demokratike, paragrafi 2 (Organizata), pika 3, [http://www.socialdemokraterna.se/upload/Internationellt/ Other%20Languages/SAPconstitution_eng.pdf](http://www.socialdemokraterna.se/upload/Internationellt/Other%20Languages/SAPconstitution_eng.pdf)



Kurdo që kongresi nuk mbledhet, kushtetuta i jep Bordit Kombëtar autoritet për vendimmarrje. Bordi Kombëtar zgjidhet nga Kongresi dhe ka 33 anëtarë. Bordi Kombëtar luan një rol kyç në zhvillimin politikave të partisë dhe në vendimmarrjet strategjike.

Kushtetuta i jep të gjithë anëtarëve të partisë të drejtën për të nisur një mocion për politika në kongres. Një individ duhet së pari t'ia paraqesë mocionin ekzekutivit të degës së tij ose të asaj lokale. Dega pastaj vendos nëse mocioni duhet të përparojë dhe, nëse është po, e paraqet atë në nivelin e qarkut. Qarku pastaj vendos nëse do të miratojë kërkesën si të veten dhe t'ia dërgojë kongresit, që të lejojë mocionin të vazhdojë për në kongres pa miratim, ose ta refuzojë mocionin plotësisht. Mocionet me miratim marrin konsideratë prioritare në kongres.

Një numri të grupeve të tjera u është dhënë autoritet nga kushtetuta që gjithashtu të paraqesin mocione para kongresit, përmes kapacitetit të tyre ose me anë të delegatëve. Ata janë si në vijim:

- Bordi Kombëtar
- Grupi Parlamentar
- Grupi i Parlamentit European
- Komisioni për Program
- Udhëheqësi i Partisë Rajonale
- Përfaqësuesi i organizatave të Këshillit të Qarkut dhe atij Komunal
- Federata Kombëtare e Grave Social Demokratike
- Rinia Social Demokratike e Suedisë
- Kristianët Social Demokratik të Suedisë
- Studentët Social Demokratik të Suedisë

Çdo mocion që ndikon në programin e partisë, e që është një deklaratë e vlerave dhe besimeve kryesore të partisë, duhet që para kongresit ti dorëzohet Komisionit për Program. Të gjitha mocionet që ndikojnë në politikat e partisë shqyrtohen nga Bordi Kombëtar. Bordi u përgjigjet të gjitha këtyre mocioneve, si dhe përcjellë propozimet e veta, duke ua paraqitur një dokument të gjitha degëve lokale, rajoneve të partisë dhe delegatëve të paktën gjashtë javë para kongresit. Ky dokument përshkruan pozicionin e Bordit për të gjitha mocionet.

Kushtetuta përcakton rregulla të ngjashme për zhvillimin e politikave në këshillin e qarkut dhe në nivel komunal. Para zgjedhjeve, kongresi i partisë së rrethit harton programin e politikave, i cili përbën direktivat e politikave për përfaqësuesit e zgjedhur të partisë.

Kushtetuta detyron anëtarët e zgjedhur të punojnë ngushtë me anëtarët e partisë në mënyrë që ata ti dinë opinionet e tyre mbi çështjet e politikave. Ajo gjithashtu u kërkon anëtarëve të partisë të pranojnë se të gjitha detajet e politikës partiake nuk mund të vendosen në takime (p.sh., disa vendime politike do të bëhen pa praninë apo konsultimin e anëtarëve të zakonshëm), dhe për të kuptuar se jo të gjithë zyrtarët e zgjedhur do të mbajnë qëndrim të njëjtë për një çështje politike.²⁷

²⁵ Po aty., Neni 7 (Bordi Kombëtar i Partisë), Pika 1.

²⁶ Po aty., Neni 4 (Kongresi Partiak), Pika 12.

²⁷ Po aty., Rregullat për Bashkëpunimin ndërmjet përfaqësuesve të zgjedhur dhe Organizatave të Partisë.



ZHVILLIMI I POLITIKAVE NË PRAKTIKË

Në praktikë SAP zhvillon politika për tri fusha kryesore.

Programi i Partisë - Kjo është një deklaratë e vizionit të partisë dhe vlerat e saj thelbësore. Ai është zhvilluar kryesisht nëpërmjet Komisionit të Programit dhe Kongresit.

Udhëzimet Politike - Ky është një dokument që përshkruan angazhimet dhe synimet e përgjithshme politike të partisë gjatë një cikli katërvjeçar zgjedhor. Ai në masë zhvillohet nga Bordi Kombëtar por duhet miratuar nga Kongresi.

Manifesti i Partisë - Kjo është oferta politike e partisë për votuesit përpara zgjedhjeve. Ky është një dokument shumë më i detajuar se Udhëzimet Politike dhe përfshin analiza mbi shpenzimet dhe rezultatet e planifikuara të zbatimit të politikave të propozuara. Manifesti përgjithësisht lëshohet rreth një muaj para zgjedhjeve dhe zhvillohet nga Bordi Kombëtar.

Në vitin para se të mbahet kongresi, Bordi Kombëtar harton dokumente për konsultim mbi çështjet e politikave, të cilat pastaj shpërndahen në kuadër të partisë. Këto dokumente përfshijnë një përmbledhje të çështjeve në shqyrtim dhe pyetje specifike që duhet të adresohen.

Qëllimi i këtyre dokumenteve është të gjenerojnë interes mbi çështjet e politikave brenda partisë dhe të nxisin diskutime në nivel lokal, të cilat mund të sjellin materiale për Bordin Kombëtar ose Komisionin për Politika. Takimet organizohen në nivele të ndryshme brenda partisë për të diskutuar konsultimet. Partia ka përdorur edhe grupe tematike diskutimi në internet për të lehtësuar një dialog kombëtar mbi çështjet relevante dhe ta bëjë pjesëmarrjen më të lehtë për anëtarët, pa pasur nevojë të udhëtojnë. Anëtarët e partisë mund të përgjigjen si një grup (p.sh., një degë lokale ose një grup i kuvendit të brendshëm), ose si individ.

Përgjigja që Bordi Kombëtar merr për dokumentet e konsultimit drejton dhe udhëzon propozimet e politikave të cilat Bordi i paraqet në Kongres.

Komiteti Ekzekutiv, i cili është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të partisë, duhet të sigurojë që zotimet e bëra në Programin e Partisë, Udhëzimet Politike dhe Manifestit të Partisë janë të gjitha në përputhje.

Komisioni për Program, i cili është përgjegjës për zhvillimin dhe hartimin e Programit të Partisë, kryesohet nga lideri i Partisë, i cili është edhe kreu i Grupit Parlamentar të partisë. Kjo siguron që nevojat e zyrtarëve të zgjedhur të partisë të jenë të përfaqësuara në Programin e Partisë, dhe gjithashtu që zyrtarët e zgjedhur të jenë plotësisht të informuar për përmbajtjen e platformës kur zhvillojnë një agjendë legislative për partinë në parlament.

Mocionet për kongres të cilat janë propozuar nga degët e partive ose nga anëtarët individual janë të ndara në mocione politike të cilat ndikojnë në politikën e partisë, si dhe propozimet organizative, të cilat ndikojnë në atë se si funksionon partia. Të gjitha mocionet filtrohen nga Komisioni për Program ose Bordi Kombëtar para kongresit.



Ashtu si shumë parti politike, SAP përjeton tensione të vazhdueshme mes Grupit Parlamentar dhe Bordit Kombëtar për çështje të zhvillimit të politikave dhe vendim-marrjes. Grupi Parlamentar mbledhet çdo javë dhe, duke qenë se ka përgjegjësi legjislative në parlament është pajisur të veprojë në çështjet e politikës. Ritmi i politikës dhe kërkesat e kalendarit legjislativ mund të shtyjnë Grupin Parlamentar të veprojë pa u konsultuar me Bordin Kombëtar apo organet e tjera relevante brenda partisë.

SAP është marrë me këtë dinamikë duke i dhënë liderit të Partisë rolin kritik të ndërmjetësuesit dhe menaxherit, duke punuar për të mbajtur interesat e të gjitha organeve përkatëse në kuadër të partisë në konsideratë kur është fjala për zhvillimin e politikave. Partia gjithashtu insiston që takimet në mes të Grupit Parlamentar dhe Bordit Kombëtar të mbahen në selinë e partisë në vend të ndërtesës së parlamentit, duke përforcuar mesazhin se vendimmarrja në politika është një përgjegjësi e partisë dhe nuk i përket vetëm zyrtarëve të zgjedhur.



PARTIA POPULLORE PËR LIRI DHE DEMOKRACI, HOLANDË



HISTORIKU DHE PËRMBLEDHJA

Partia Popullore për Liri dhe Demokraci (VVD) në Holandë u themelua në vitin 1948 si një vazhdimësi e disa lëvizjeve Liberale.

Të drejtat e anëtarëve individual janë mishëruar në statutet e partisë. Të gjithë anëtarët e partisë kanë të drejtë të flasin dhe të votojnë në Asamblenë e Përgjithshme, e cila është organi më i lartë vendimmarrës i partisë.

VVD përdor një strukturë komitetesh për të krijuar politika. Komitetet e bazuara në çështje janë formuar dhe udhëhiqen nga anëtarët e partisë që të bëjnë hulumtime dhe të propozojnë alternativa politike për partinë. Këto pastaj i dorëzohen Asamblesë së Përgjithshme për ndryshime dhe miratim.

Statutet e VVD vendosin strukturat e vendimmarrëse të partisë dhe caktojnë të drejta dhe autorizimet specifike për anëtarët individual, degët lokale, dhe udhëheqjen e partisë. Në vitin 2004, VVD zhvilloi një veprimtari të konsultimit për të ndërtuar një Manifest të Ri Liberal. Një komision i veçantë u formua për t'u angazhuar me anëtarët e partisë dhe udhëheqësit që të përcaktojnë vlerat thelbësore të partisë dhe vizionin e saj për të ardhmen.

ZHVILLIMI I POLITIKAVE SIPAS STATUTEVE PARTIAKE

VVD udhëhiqet nga një grup i statuteve dhe akteve nënligjore. Statutet krijojnë Asamblenë e Përgjithshme, si organin më të lartë vendimmarrës brenda partisë. Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën dy herë në vit. Të gjithë anëtarët e partisë kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të flasin në asamble. Çdo anëtar partie ka të drejtën e votës në asamble. Votat e anëtarëve janë personale dhe të pa transferueshme.²⁸

Programi zyrtar i partisë për politika vendoset nga ana e Asamblesë së Përgjithshme, që plotëson dhe miraton ose refuzon punën e komiteeve të partisë politike. Asambleja e Përgjithshme mund gjithashtu të marrë vendime për çështje politike.

Statutet e VVD gjithashtu krijojnë Këshillin e Partisë i cili ofron udhëzime dhe vendime mbi çështjet politike. Këshilli i Partisë zgjidhet nga anëtarët në mbledhjet e degëve rajonale. Ajo gjithashtu administron këshillat për Bordin e Partisë, i cili merret me punët e përditshme të partisë kur Asambleja e Përgjithshme nuk mbledhet. Megjithatë, statutet gjithashtu e bëjnë të qartë se Asambleja e Përgjithshme ka përparësi ndaj Këshillit të Partisë. Asambleja e Përgjithshme e mban të drejtën të kundërshtojë politikën e miratuar nga Këshilli, në cilën pikë vendimi i Asamblesë së Përgjithshme bëhet politikë zyrtare e partisë.²⁹

²⁸ Statutet e VVD, Neni 16, <http://www.vvd.nl/over-de-vvd/detail/19/partijreglementen>

²⁹ Po aty., Neni 28.



ZHVILLIMI I POLITIKAVE NË PRAKTIKË

VVD përdor një sistem të komiteteve për të zhvilluar politikat e partisë. Komitetet e bazuara në çështje udhëhiqen plotësisht nga anëtarët e partisë, nuk janë të përfshirë as deputetët dhe as anëtarët e udhëheqjes së partisë.

Menjëherë pas zgjedhjeve kombëtare, komitetet krijohen për të menaxhuar fusha specifike të politikave siç janë kujdesi shëndetësor, siguria, arsimi, etj. Komitetet përbëhen prej anëtarëve të partisë që janë ekspertë ose me eksperiencë të madhe për tema të caktuara.

Komitetet takohen përafërsisht një herë në muaj për të diskutuar dhe formuluar politikat në emër të partisë. Ata gjithashtu mund të formojnë nën-grupe nëse është e nevojshme për të ndarë një temë të madhe në pjesë të menaxhueshme.

Komitetet prodhojnë draft-dokumente për politika, të cilat i dorëzohen Asamblesë së Përgjithshme të partisë. Këto gjithashtu shpërndahen edhe në degët lokale të partisë para takimeve të Asamblesë. Propozimet e politikave debatohen dhe ndryshohen nga Asambleja por nuk konsiderohen si politika të partisë deri sa të miratohen nga Asambleja e Përgjithshme përmes sistemit një-anëtar-një votë. Shumica e ndryshimeve ose modifikimeve në propozimet e politikave diskutohen dhe negocohen në nivel lokal para Asamblesë së Përgjithshme.

Një sistem i ngjashëm për të përgatitur politika për zgjedhjet komunale dhe lokale ekziston edhe në nivel lokal. Në prag të zgjedhjeve të vitit 2004, VVD mori edhe iniciativën për të formuluar një manifest të ri Liberal. Qëllimi i kësaj ndërmarrjeje ishte rinovimi dhe ri-afirmimi i vlerave dhe vizionit të partisë, përtej platformës së vet zgjedhore dhe programit për politika.

Një komision i veçantë u formua për të udhëhequr konsultimin për Manifestin e ri Liberal. Komisioni konsultoi anëtarët e partisë dhe palët e interesuara për të diskutuar se çfarë duhet të ketë në dokumente. Sugjerimet dhe kritikët janë marrë me faks, postë elektronike, dhe personalisht. Partia gjithashtu ka mbajtur një “Ditë të ideve” një ngjarje për të gjeneruar sugjerime dhe reagime.³⁰

Komisioni në fund të fundit prodhoi një dokument i cili identifikoi lirinë, përgjegjësinë, tolerancën, drejtësinë sociale, dhe barazinë e mundësive si parimet e saj kryesore. VVD vazhdon t’i referohet këtij Manifesti Liberal si deklaratë e tij e vizionit dhe një nga dokumentet themelore të bërthamës së saj.

Komisioni i posaçëm për Manifestin Liberal përsëri raportoi mbi rëndësinë e ruajtjes së një kulture të hapur brenda partisë, në të cilën shkëmbimi publik i mendimeve, ideve dhe qëndrimeve është i inkurajuar, dhe ku ka vend për iniciativat e anëtarëve individual.³¹

³⁰ Po aty., Lidhje tek Manifesti Liberal.

³¹ Po aty.



FINE GAEL, IRLANDË



HISTORIKU DHE PËRMBLEDHJA

Fine Gael është një parti politike e qendrës së djathtë në Republikën e Irlandës. Partia u formua në vitin 1933, duke dalë nga lufta civile post-koloniale e vendit, nga ana e lëvizjes pro-traktatit të udhëhequr nga Michael Collins, si dhe nga forcat dhe organizatat e tjera të ngjashme të të njëjtit mendim politik.

Kushtetuta dhe rregullat e Fine Gael-it i japin Partisë Parlamentare rolin udhëheqës në çështjet e politikës, e cila është e përbërë nga ata që zgjidhen në parlamentin kombëtar dhe Parlamentin Europian. Autoriteti i Partisë Parlamentare është subjekt i miratimit nga organi kryesor qeverisës i partisë, të Ard Fheis-it. Megjithatë, nga Ard Fheis-i kërkohet vetëm që të mbledhet të paktën një herë në çdo dy vjet.

Parlamentarët e bankës së parë inkurajohen të ngrenë grupe specialistësh me ekspertizë të veçantë apo interes në fushat për çështjet për të cilat ata kanë përgjegjësi. Parlamentarët e bankës së parë përdorin këto grupe për të mbajtur veten të informuar mbi çështjet kyçe, por edhe të shërbehen me ekspertizën teknike të grupeve të specialistëve.

Propozimet e politikave përndryshe janë thellësisht të bazuara në punë kërkimore. Konsultimet publike nuk luajnë ndonjë rol të rëndësishëm në këtë model, dhe anëtarët përfshihen në zhvillimin e politikave vetëm në raste të veçanta.

ZHVILLIMI I POLITIKAVE SIPAS STATUTEVE PARTIAKE

Kushtetuta dhe rregullat e Fine Gael-it rolin kryesor në çështjet e politikave ia japin Grupit Parlamentar të Partisë.³² Partia Parlamentare është e përbërë nga të gjithë ata që zgjidhen në *Wireann Dail* (Dhoma e ulët e parlamentit), *Seanad* (Dhoma e lartë e parlamentit), si dhe në Parlamentin Europian, pra ata që kanë marrë votat e partisë.

Autoriteti i Partisë Parlamentare është subjekt i miratimit të *Ard Fheis*, i cili është organi kryesor qeverisës i partisë.³³ Partia Parlamentare duhet të sigurojë një deklaratë për politikat aktuale të partisë në të gjitha degët e partisë dhe organet ekzekutive para çdo *Ard Fheis*, si dhe duhet të paraqesë një deklaratë të konsoliduar të politikës së partisë në çdo *Ard Fheis*. Megjithatë, duke qenë se një ngjarje e tillë është e kushtueshme dhe kërkon mjaft kohë, *Ard Fheis* duhet të mbledhet vetëm një herë në 24-muaj, dhe mund të shtyhet më tej në rrethana të jashtëzakonshme, e kjo i jep Partisë Parlamentare një pavarësi të mjaftueshme.³⁴

³² Kushtetuta dhe Rregullat e Fine Gael, (prill 2010), Këshilli Partiak, Pjesa V, Rregulla 38 (i), fq. 25.

³³ Po aty.

³⁴ Po aty., Ard Fheis, Pjesa XI, Rregulla 54 (I-II), fq. 42.



ZHVILLIMI I POLITIKAVE NË PRAKTIKË

Edhe pse Kushtetuta e Fine Gael-it i jep përgjegjësi për zhvillimin e politikave gjithë Partisë Parlamentare, në aspektin praktikë ajo mëton të përcaktohet nga Parlamentarët e bankës së parë të partisë (dmth., ministrat e kabinetit kur janë në qeveri, dhe kabinetit në hije kur janë në opozitë).

Çdo anëtar i Parlamentarëve të bankës së parë është përgjegjës për të hulumtuar dhe zhvilluar fushën e vet të politikës. Për të forcuar këtë proces, partia ka punuar për të zhvilluar hulumtim, zhvillim të politikave, debate dhe aftësitë legjislative të parlamentarëve të saj. Partia ka emëruar edhe një numër të stafit të politikave për profesionalizimin e procesit.

Parlamentarët e bankës së parë janë të inkurajuar të krijojnë grupe të specialistëve me ekspertizë apo interes të veçantë në fushat e çështjeve për të cilat ata kanë përgjegjësi. Këta mund të jenë njerëz biznesi, akademikë, organizata të shoqërisë civile, etj. Disa mund të jenë anëtarët të partisë, por kjo nuk është kriter i domosdoshëm. Parlamentarët e bankës së parë përdorin këto grupe për të qenë të informuar mbi çështjet kyçe, por edhe të shërbehen me ekspertizën. Përndryshe, partia mbështetet thellësisht në hulumtime të rregullta për zhvillimin e politikave. Hulumtimet cilësore dhe sasiore rregullisht përdoren për të zhvilluar idetë e politikave, alternativa testuese, dhe pozicionet e ratifikuara.

Konsultimet formale me anëtarët mbi politikat zhvillohen në bazë të nevojës. Shembulli më i fundit i një konsultimi të madh ka qenë në nëntor të vitit 2008. Pas zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 2007, në të cilën Gael Fine u mund, kreu i partisë krijoi një numër të komisioneve për politika në çështjet madhore. Si pjesë e procesit, u organizua një seancë e veçantë gjatë konferencës kombëtare, ku anëtarët e partisë paraqitën propozime dhe debatuan. Nga ky proces dolën pozicione të rëndësishme të politikës, duke përfshirë politikën FairCare mbi shëndetin.



UNIONI PËR LËVIZJE POPULLORE, FRANCË



HISTORIKU DHE PËRMBLEDHJA

Unioni për Lëvizje Popullore (UMP), në Francë u formua në vitin 2002 nga ish-Presidenti dhe nga Kryeministri Francez, Zhak Shirak, si një aleancë e qendrës së djathtë e disa partive politike.

Në prag të zgjedhjeve kombëtare, UMP organizon konsultime të mëdha për politika dhe përmbajtjen e platformës së saj. Për shembull, në përgatitje për zgjedhjet presidenciale dhe legjislativë të vitit 2007, UMP filloi Projektin për Francën, i cili gjeneroi më shumë se 500 propozime politikash. Me zgjedhjet e caktuara për pranverën e 2012, UMP ka hapur një iniciativë të ngjashme të quajtur Projekti 2012, i cili është duke mbledhur mendimet e popullatës së gjerë, duke përfshirë anëtarët e partisë dhe mbështetësit, grupet e ekspertëve, shoqatat profesionale, zyrtarët e zgjedhur, dhe madje edhe votuesit që nuk janë as anëtarë e as mbështetës të UMP.

UMP është angazhuar në ndërmarrjen e konsultimeve të mëdha dhe gjithëpërfshirëse për politika që nga ditët e saj të hershme. Megjithatë, kjo nuk bazohet në statutin e partisë por, më tepër, ka dalë për arsye shumë më pragmatike, së pari nevoja për të unifikuar dhe mobilizuar koalicionin e partive dhe lëvizjeve të ndryshme politike që përbëjnë UMP-në.

ZHVILLIMI I POLITIKAVE NË STATUTET PARTIAKE

UMP udhëhiqet nga një grup i statuteve dhe rregulloreve të brendshme. Statutet u garantojnë anëtarëve të drejtën për t'u angazhuar në debat brenda partisë dhe të votojnë në kongres.

Kongresi është i përbërë nga të gjithë anëtarët e partisë të cilët nuk kanë detyrime të prapambetura (kuota anëtarësie) në kohën e mbajtjes së tij. Kongresi, “parasheh veprimet e përgjithshme dhe orientimin politik të partisë. Ai zgjedh kandidatin e mbështetur nga partia për zgjedhjet e presidentit të republikës.”³⁵

Mocionet politike mund të paraqiten në Kongres, por kjo duhet të bëhet përmes fraksioneve brenda UMP e jo nga anëtarët individualë. Mocionet politike së pari duhet të dorëzohen në Byronë Politike të partisë.³⁶

Byroja Politike mblidhet rregullisht dhe është përgjegjëse për menaxhimin e përditshëm të çështjeve politike. Byroja Politike mbikëqyret nga Këshilli Kombëtar, i cili mblidhet dy herë në vit dhe është i ngarkuar me marrjen e vendimeve për orientimin politik të partisë kur nuk takohet kongresi.³⁷

³⁵ Statutet dhe Rregulloret e Brendshme të UMP (NDI përkthim), Kongresit, neni 14.

³⁶ Po aty., Neni 17.

³⁷ Po aty., Nenet 20 dhe 24.



ZHVILLIMI I POLITIKAVE NË PRAKTIKË

UMP ka zhvilluar një formë të gjerë dhe shumë përfshirëse të zhvillimit të politikave. Partia përpiqet të arrijë te një publik sa më i gjerë të jetë e mundur për të mbledhur reagime, këshilla të ekspertëve, si dhe opinione për propozimet e saj për politika. Kjo ndërmartje masive ka qenë në vitet që i paraprinë zgjedhjeve kombëtare dhe u mbikëqyr nga Sekretari i Përgjithshëm i UMP-së.

Për shembull, para zgjedhjeve presidenciale dhe legjislativë të vitit 2007, UMP zhvilloi aktivitete në mënyrë që konsultimi mbi politika të arrijë larg, kjo njihet si projekti për Francë, me moton “Le të ndërtojmë platformën e së ardhmes: Një platformë, një Ekip”. Duke qenë se UMP është një aleancë e disa partive dhe lëvizjeve politike, ishte e rëndësishme që UMP të arrijë një platformë politike të mbështetur nga të gjithë anëtarët e saj.

U krijuan komitete të politikave, të përbërë nga ligjvënësit e partisë. Puna e këtyre komiteteve udhëhoqi deri në tetëmbëdhjetë konventa të veçanta për tema apo çështje specifike. Ekspertë nga një shumëllojshmëri e fushave të ndryshme ishin të ftuar për të folur në konventa. Raportet u zhvilluan nga konventat dhe u postuan në faqen e internetit të UMP-së për debate të cilat u mbajtën nga marsi 2005 deri në tetor të vitit 2006. Shumë prej këtyre konventave dhe debateve u transmetuan drejtpërdrejtë përmes faqes së internetit të krijuar nga partia.

Përveç kësaj, partia nxori një revistë speciale për anëtarët e saj e në të cilën nga ta u kërkua të marrin pjesë në një studim duke renditur një listë të fushave politike nga më e rëndësishmja e deri te ajo më pak e rëndësishmja. Anëtarët e Partisë mund të votonin drejtpërdrejt në internet ose në zyrat e degëve. Në fund, u nxorrën më shumë se 500 propozime për politika. Një Komiteti i rastit për Platformë, i kryesuar nga udhëheqësi i partisë, mbledhi politikat e propozuara në një platformë të propozuar e cila iu paraqit Këshillit Kombëtar. Këshilli Kombëtar e rishikoi dhe ndryshoi propozimet dhe aprovoi versionin përfundimtar, i cili u vu në votim nga të gjithë anëtarët në zyrat e degëve të partisë gjatë një periudhe një javore.

Platforma përfundimtare politike u bazua rreth pesë parimeve të mëposhtme:

- Puna dhe merita
- Siguria dhe respekti
- Drejtësia dhe barazia
- Përgjegjësia dhe përgjegjshmëria personale
- Besimi

UMP-ja organizoi një aktivitet të ngjashëm para zgjedhjeve presidenciale dhe legjislativë të vitit 2012, Projekti i quajtur 2012



PJESA 4: REKOMANDIME PËR ZHVILLIMIN E POLITIKAVE

Partitë politike të shqyrtuara për këtë udhëzues përmbajnë një shumëllojshmëri të gjerë të ideologjive politike dhe qasjesh për zhvillimin e politikave. Nuk ka ndonjë mënyrë të veçantë për zhvillim të politikave dhe çdo parti politike duhet të dalë me një model që i përshtatet nevojave dhe rrethanave të saj.

Megjithatë, tregimet për partitë e shqyrtuara këtu, si edhe ekspertët e partive të intervistuar për këtë udhëzues, ofrojnë disa këshilla specifike për zhvillimin e politikave në statute dhe në praktikë.

Në statute:

1. Një parti politike duhet të dijë se cilat janë vlerat dhe orientimi i saj ideologjik para se të fillojë të zhvillojë politikën. Partitë që janë të pasigurta lidhur me këtë duhet të kenë një diskutim të brendshëm mbi parimet e tyre themelore, vizionet dhe besimet politike para se të fillojnë me zhvillimin e alternativave politike.
2. Konsideroni një formë të mekanizmit filtrues për mocionet mbi politika që shkojnë në konferencë në mënyrë që Konferenca të debatojë vetëm për ato që me të vërtetë janë të rëndësishme për partinë dhe mjedisin politik, dhe që temat e ngjashme të mos dyfishohen.
3. Të sigurojë një strukturë dhe proces mbështetës, por të shmangë vënien e shumë detajeve në statut në mënyrë që partia të ketë fleksibilitet dhe alternativa nëse dalin rrethana të reja ose të paparashikuara. Lloji i zhvillimit të politikave i cili i duhet partisë do të ndryshojë varësisht se a është në qeveri apo opozitë, e ky është mjedisi politik, etj, dhe detajet në statut duhet të jenë mjaft fleksibile për të akomoduar çdo larmi situatash.
4. Statutet që u garantojnë anëtarëve të drejtën e pjesëmarrjes në zhvillimin e politikave duhet të specifikojnë se në cilën fazë, apo faza, të procesit të hartimit të politikave, kjo është e mundur. Është e dobishme që anëtarët e partisë ta kenë të qartë se kur mund dhe duhet të përfshihen në mënyrë që të mund të përgatiten, dhe gjithashtu të mos presin që të jenë në gjendje të ndërhyjnë në vendimet politike që duhet të merren në nivelin ekzekutiv .
5. Statutet duhet të jenë mjaft fleksibile për të akomoduar dallimet në baza gjeografike dhe të një-sive partiake. Në shumicën e vendeve, anëtarësia e partisë politike do të jetë e fortë dhe aktive në disa fusha, por më pak në të tjerat. Strukturat Politike duhet të jenë në gjendje ta përshtatin nivelin e angazhimit dhe kërkesës në fushat më të forta duke mos vënë barrë të madhe në fusha më të dobëta të cilat mund të mos kenë kapacitet të njëjtë.
6. Të sigurohet se ekziston një përkrahje strukturore që organet për hulumtim dhe angazhim (dmth., anëtarësimi dhe rekrutimi) brenda partisë të punojnë ngushtë së bashku në proceset konsultative.



Në praktikë:

7. Pothuajse gjithmonë do të ketë një shkallë tensioni ndërmjet asaj që anëtarësia e partisë dëshiron dhe asaj që udhëheqja e partisë vendos apo ka nevojë të bëjë, veçanërisht kur partia është në qeveri. Përgatituni për të punuar në mënyrë konstruktive me këtë tension duke i mbajtur linjat e komunikimit të hapura, dhe duke e bërë të qartë se kur është i mundur konsultimi në vendimmarrje dhe kur jo.
8. Ritmi i vendimmarrjes për politika është përsheptuar që kur mediat, gjithnjë e më shumë, përcaktojnë axhendën politike ditore. Në këto rrethana, është e rëndësishme që të ketë procese të qarta të vendimmarrjes si dhe një dokument të fuqishëm për vlerat kryesore të partisë, i cili mund të përdoret nga të gjithë vendimmarrësit për tua dhënë drejtimin kur dalin çështje të reja dhe urgjente.
9. Përcaktoni qartë se cila pjesë e partisë do të jetë motori i politikave dhe të sigurohet që ajo të ketë resurse dhe strukturuara të afta për të lëvizur shpejt në çështjet e ngritura.
10. Është e pranueshme dhe nganjëherë edhe e preferueshme të zhvillohen sisteme për të bërë politika me kalimin e kohës. Struktura që formon një parti politike nuk ka nevojë që gjithmonë të jetë ajo që adopton, e veçanërisht nëse nuk funksionon mirë. Mos kini frikë ta ndryshoni apo rishikoni procesin derisa është në zhvillim në mënyrë që të përshtatet me nevojat dhe vlerat e partisë. Mbajini statutet dhe aktet nënligjore mjaft të gjera në mënyrë që të mund të ndryshohen më vonë nëse është e nevojshme.
11. Sigurohuni që anëtarët e komisionit për politika apo organi politikëbërës të jenë të trajnuar në mënyrë adekuate dhe ti kenë burimet e nevojshme që ta bëjnë punën e tyre siç duhet.
12. Mos kini frikë të konsultoheni jashtë partisë dhe të përfshini publikun e gjerë, por kini kujdes me proceset e konsultimit që janë të mëdha sepse asgjë me vlerë nuk del asnjëherë prej tyre (dmth., idetë e mira lehtë mund të rrëshqasin dhe të humbin në qoftë se një proces është shumë i madh).
13. Reagimet dhe trajtimi i tyre në vazhdimësi janë çelësi për konsultime të mira politike. Nëse një individ apo organizatë propozon një ide politike të cilën partia e miraton, sigurohuni që ata ta dinë këtë.
14. Përfaqësimi i larmishëm mund të kontribuojë për politika të mira. Përveç përfshirjes së ekspertëve tematik në zhvillimin e politikave, gjinia, minoritetet, dhe ekuilibri rajonal mund të bëjnë një ndryshim në vlerën e asaj që është propozuar.
15. Një ndryshim në cilësinë dhe qartësinë e përgjigjeve të marra mund ta bëjë edhe mënyra se si formulohen pyetjet në një konsultim. Mund të jetë e dobishme të merren këshilla nga studiuesit apo anketuesit se si të bëhen pyetje të mira dhe të hapura.
16. Praktikuesit gjithashtu këshillojnë se kur organizohet një konsultim, partia nuk duhet të bëjë pyetje përgjigjet e të cilave nuk duan ti dinë. Nëse një çështje është shumë e ndjeshme ose kundërthënëse, shikoni nëse ka ndonjë platformë tjetër për diskutim brenda partisë që është më e përshtatshme se konsultimi. Në anën tjetër, konsultimi nuk mund të jetë vetëm një ndërmarrje e pakuptimtë. Nëse një parti dëshiron të angazhohet në konsultime, ajo duhet të jetë sinqerisht e përgatitur të kalojë nëpër proces dhe tu përgjigjet gjetjeve sinqerisht.



PJESA 5: LISTA E BURIMEVE

Partia Laburiste, Mbretëria e Bashkuar

Partneriteti në fuqi, konferenca Vjetore 2010: Rishikimi i bërjes së politikave të Partisë laburiste, <https://www.gmb.org.uk/pdf/2010%20NPF%20Review%20Document.pdf>

Libri i Rregullave i Partisë Laburiste (2010), <http://www.leftfutures.org/wp-content/uploads/2011/02/Labour-Party-Rule-Book-2010.pdf>

Faqja e internetit të Partisë Laburiste për Konsultime për Politika, <http://www.labour.org.uk/havingyoursayinshapingpolicy>

Partia Konservatore, Mbretëria e Bashkuar

Faqja e internetit e Forumit Konservatorë për Politika, <http://www.conservativepolicyforum.com/>

Kolumni i Partisë Konservatore për Forumin Konservatorë për Politika (përfshirë lidhjen në dokumentin [për konsultime për ekonomi)

<http://conservativehome.blogs.com/thinktankcentral/2011/04/the-conservative-policy-forum-wants-to-know-your-views-on-what-will-be-the-uks-main-industries-and-e.html>

Kushtetuta e Partisë Konservatore në dispozicion përmes NDI-së.

Partia Social Demokratike, Suedi

Dokumenti për Diskutim, “Një Suedi për Nesër”, për tu rishikuar dhe ndërruar programi dhe strukturën e partisë (2011), <http://www.socialdemokraterna.se/upload/Internationellt/Other%20Languages/2011/A%20Sweden%20for%20tomorrow.pdf>

Kushtetuta e Partisë Social Demokratike Suedeze (Anglisht), http://www.socialdemokraterna.se/upload/Internationellt/Other%20Languages/SAPconstitution_eng.pdf

People’s Parta Popullore për Liri dhe Demokraci, Holandë

Rregullorja e VVD dhe Manifesti Liberal, <http://www.vvd.nl/over-de-vvd/detail/19/partijreglementen>

Unioni për Lëvizje Popullore, Francë

Statutet dhe Rregullat Proceurale të UMP-së, <http://www.u-m-p.org/notre-parti/organisation>
Project 2012 Website,, <http://www.projet-ump.fr/>

Fine Gael, Irlandë

Vlerat e Partisë Fine Gael Party, <http://www.finegael.ie/your-fine-gael/values/>



Fine Gael Constitution and Rules available through NDI

Materialet Shtesë

Standardet Europiane për Konsultime,
http://ec.europa.eu/civil_society/consultation_standards/index_en.htm

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) Udhëzues për Konsultime për Politikëbërje, <http://www.oecd.org/dataoecd/24/34/2384040.pdf>

Faqja e Internetit të Liberal Demokratëve (Mbretëria e Bashkuar) për Konsultime për Politika,
<http://consult.libdems.org.uk/>

